

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7786 E enjte 7 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Siç raporton radio "Evropa e Lirë", Se cila u referohet burimeve të Inteligjencës Amerikane, Ballkani Perëndimor është në rrezik të ndonjë konflikti ushtarak...
Vijon në faqet 20-21

Nga MUJË BUÇPAPAJ

A është Ballkani në rrezik të ndonjë konflikti ushtarak?



Opinion i Ditës

Më vetëm tri fjalë të shkurtra dhe një konstatim të thjeshtë, Albin Kurti ka trazuar regjimin e Tiranës më shumë se sa dhjetëra fjalime e aksione opozitare ...
Vijon në faqen 21

Nga ARMAND SHKULLAKU

Kë frikësoi në Tiranë, Albin Kurti



Sistemi elektronik në gjykata, 12 nën hetim

Pranga 4 zyrtarëve të Ministrisë së Drejtësisë, hetimi: Abuzuan me tenderat

Pranga ish-sekretares së Përgjithshme, Juliana Hoxha dhe drejtorit. Prokuroria: Dëm miliona euro

Nga KLODIANA LALA


TIRANË - Hetimet më shumë se njëvjeçare të Prokurorisë së Tiranës shkaktuan një furtunë të vërtetë në Ministrinë e Drejtësisë. Katër zyrtarë dhe ish-zyrtarë të lartë të këtij institucioni u vunë nën arrest, pas dyshimeve për ...

Në faqen 8

KRIMI NE VLORE/ 57-VJEÇARI RENDE NE SPITAL. FQINJET: ISHTE XHELOZ

BURRI MBYT GRUAN DHE PRET DAMARET E DUARVE

Nëna e 4 fëmijëve ndërron jetë në shtëpi. Dy vite më parë, Teodor Lera i çau kokën, Eva e fali për hir të fëmijëve. Ai nuk punonte, familjen e mbante ajo



(Në foto) Eva me bashkëshortin Teodor Lera. Policia në vendin e ngjarjes



Në faqen 9

PRESIDENTI

Kufijtë e Kosovës me Serbinë, Thaçi nga SHBA: Putin më ka dërguar mesazh

Në faqen 16

ISH-GUVERNATORI

Fullani merr post në bankën qendrore malazeze, mediat: U shkarkua e u arrestua

Në faqen 7

KUSH KALOJ TESTIN

Lista e tretë, infermierët në Durrës, Kukës, Fier e Gjirokastrë

Në faqet 12-13

PERPLASJA E PLOTE

"S'je gjeneral, por ushtar", debatet e opozitës me Sandër Lleshajn në komision

Në faqen 2

BISEDAT E DRITAN GRAMOZIT



"Kalo nga Kakavija", "është bërë keq", përgjimet e trafikut drejt SHBA dhe BE

Në faqen 5

PD mbledh grupin parlamentar: Betejë me qytetarët dhe në parlament

Ultimatumi i Bashës: Rama, afat deri në 15 shkurt

"Të ikë nga karrigia që i falën kriminelët. Duam qeveri tranzitore"

Aksioni opozitar ishte dhe në qendër të mbledhjes së grupit parlamentar të demokratëve. Krahas takimeve me elektoratin në bazë, në prag edhe të protestës së 16 shkurtit, opozita do ta vijojë betejën politike edhe në parlament. Ata vendosën që edhe sot do të fokusohen tek



aferat e qeverisë, ku sërisht do të kërkojnë krijimin e një qeverie tranzitore që t'u hapë rrugë zgjedhjeve të lira. Kreu i PD, Lulzim Basha, më pas vijoi takimet në kuadër të protestës së 16 shkurtit. Basha ishte në Vorë, ku u takua me qytetarë të ndryshëm ...

Në faqen 4

PROTESTA PËRPLASJA

PS dhe opozita janë përplasur në Komisionin e Edukimit për dhunën ndaj studentëve

PD: Nga gjeneral je kthyer në ushtar; Lleshaj: Policia zbatoi ligjin

"As Hekuran Isai nuk e ka bërë këtë; do ju tërheqim zvarrë"

Ardhja e ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj në Komisionin parlamentar për Edukimin dhe Median është shndërruar në një përplasje të gjatë dhe të ashpër mes mazhorancës dhe opozitës. Ndërsa kishte ftuar ministrin për t'iu përgjigjur shqetësimit për përdorimin e dhunës së policisë ndaj studentëve protestues, komisioni është përfshirë në një debat ku nuk kanë munguar edhe etiketimet personale apo edhe akuzat politike. Mbledhja ka nisur e tensionuar dhe tonet u ngritën ndeshëm kur deputetja e LSI-së Kejdi Mehmetaj kërkoi nga ministri një shpjegim për ndërhyrjen e policisë brenda auditoreve të universiteteve përgjatë protestës studentore. Duke paragjykuar moshën e re, ministri i Brendshëm ironizoi pyetjen e deputetes së LSI-së, duke u përgjigjur se "Me ju do flas kur të mbaroni universitetin". Kaq ka mjaftuar që komisioni të shpërthejë në një debat, teksa deputetët e opozitës e kanë akuzuar atë që për një fjalor dhe për komente të papërshtatshme. "Kjo është shumë, është e tepërt!", - deklaroi kryetarja e komisionit, Albana Vokshi, teksa ka ftuar edhe kolegët e majta që të distancohen nga ministri. Ndërsa vetë deputetja e LSI-së, Mehmetaj ka deklaruar se sjellja e ministrit është reflektim i sjelljes së policisë së shtetit. "Ju jeni reflektimi i atyre policëve atje, ato fjalë që policët tuaj me urdhrin tuaj ua kanë thënë studentëve ju i meritoni një nga një dhe ashtu sic ata studentët kanë reaguar, do t'ju tërheqim zvarrë nga zyra. Këtu po flisni me një deputete, nuk keni punë me arsimin tim. Ju duhet t'i përgjigjeni këtij ligji, është përgjegjësia juaj ligjore, përndryshe nesër mund të përfundoni në burg.

Vokshi: Eshhtë përfaqësuese e qytetarëve, e sovranit. Jo, kjo është shumë, është e tepërt!
Mehmetaj: Ju jeni reflektimi i atyre policëve atje, ato fjalë që policët tuaj me urdhrin tuaj ua kanë thënë studentëve ju i meritoni një nga një dhe ashtu sic ata studentët kanë reaguar, do t'ju tërheqim zvarrë nga zyra. Këtu po flisni me një deputete, nuk keni punë me arsimin tim. Ju duhet t'i përgjigjeni këtij ligji, është përgjegjësia juaj ligjore, përndryshe nesër mund të përfundoni në burg.

Vokshi: T'ju je deputetja zvarritëse e?! Do të na zvarritëse ti e...
Vokshi: Ju tërheq vërejtje për të disatën herë. Më vjen çudi që kolegët këtu nuk ndërhyjnë ndaj komenteve tuaja të papërshtatshme. Ju nuk vjen çudi e, nuk reagoni kur një ministër ofendon një kolege tuajën?! Kini kujdes, tregoni etikë për mënyrën sesi i drejtoheni gjithësecilit prej deputetëve. Janë përfaqësues të sovranit që të gjithë. Do t'i përgjigjeni pyetjeve të të gjithëve...Nuk mundet të shkëlqi etikën në një sallë, mund ta bëni jashtë.
Kejdi Mehmetaj: Eshhtë një turp i madh që Policia e Shtetit diskriminon fëmijet e shqiptarëve. Ju mbase nuk keni fëmijë se me shumë siguri nuk do flisnit kështu.
Lleshaj: Unë i kam fëmijët, por i kam pak ndryshe nga ju!

Lleshaj: Flesa për dëgjesë në Komision mbi bazën e çfarë neni është bërë Vokshi: Ju para se të vini këtu nuk e paskeni lexuar. Nuk raportohet vetëm për kryeministrin, por edhe para parlamentit. Eshhtë detyrim kushtetues. Pyetja juaj është e pavend.
Lleshaj: Përball Kushtetutës jemi të gjithë të barabartë. Kam afat tre javë për t'ju përgjigjur. Sa i përket çështjes suaj, pyetja juaj, në fakt, është përgjigje. Strukturat e Policisë nuk kanë ushtruar asnjë dhunë ndaj studentëve protestues. Nuk ka patur asnjë dhunë, përkundrazi. Këtu nuk ka mundësi që të përdor gjuhën e gabuar ndaj meje askush. Kam ardhur me bindjen se jam në një komision parlamentar.
Vokshi: Këtu nuk mund të kërcënohi asnjë deputet dhe të përdorni një gjuhë të papërshtatshme.
Lleshaj: Nuk kam ardhur për të parë film këtu. Unë kam ardhur të përgjigjem pyetjeve. Nuk bëj komentimin e videove.
Vokshi: Kush e dha urdhrin për dhunë ndaj studentëve?



Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj

DEBATI

Duke paragjykuar moshën e re, ministri i Brendshëm ironizoi pyetjen e deputetes së LSI-së, duke u përgjigjur se "Me ju do flas kur të mbaroni universitetin". Kaq ka mjaftuar që komisioni të shpërthejë në një debat të ashpër, teksa deputetët e opozitës e kanë akuzuar atë që për një fjalor dhe për komente të papërshtatshme.



Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj në Komisionin parlamentar për Edukimin dhe Median

DEBATI, NOKA: JU GËNJENI; MINISTRI: TËRHIQE, NUK JAM NGA AI FIS QË GËNJEJ

Vokshi: Forcat e Policisë së Shtetit janë angazhuar për mbarevajtjen e protestës së studentëve. Nuk ka patur asnjë urdhrë për dhunë ndaj studentëve që kanë marrë pjesë në protestën e muajit dhjetor. Policia ka qenë në shërbim të këtij qëllimi. Policët kanë ndihmuar që protesta të shkojë mirë dhe në fakt ka shkuar shumë mirë.
Salianji: Pse nuk e keni marrë drejtorin e Policisë së Shtetit? Ne ju kemi thirrur në mënyrë specifike, as Hekuran Isai nuk ka guxuar ta bëjë këtë, e keni dhënë ju urdhrin, apo një titullar më i larë se ju që mund të jetë Kryeministri? Pasi reagon opozita, mediat e qdo institucioni tjetër, detyra e një ministri është të bëjë heitime, e të dalë me përfundim për të dalë me përgjigje, apo për të hequr nga përgjegjësia. Po ju personalisht, meqë keni qenë gjeneral i Republikës dhe nuk besoj se do ktheheni në ushtar të kryeministrit dhe ju të ligjit

Vokshi: Ministri i Brendshëm e pranoi vetë që ngjarja kishte ndodhur, nuk kishin informuar sepse e quajti publiciteti pavarësisht se ishte krim monstruz. E pranoi vetë që kishte fshehur krimin. Se me çfarë tagri përçakton ministri se është publiciteti apo jo?! E pranoi vetë se kishin fshehur ngjarjen.
Lleshaj: Personat në fjalë janë ndaluar nga policia e Shtetit para se shefi juaj ta bënte publike.
Vokshi: A është Ishehur ngjarja
Lleshaj: Jo.
Vokshi: Pse nuk e keni në komunikatë?
Lleshaj: Eshhtë referuar në prokurorin.
Vokshi: Jo, në komunikatë zyrtare.
Lleshaj: Eshhtë referuar në Prokurorin.
Noka: Ish-kryeministri Berisha e ka me datë denoncimin, na tregoni ju një dokument që tregon me datë se keni bërë referim në Prokurorin. Ju gënjëni.
Lleshaj: Zoti Noka, atë fjalë tërhiqe nuk jam nga ai fis unë që gënjëni.
Noka: Nuk të kemi thirrur për fis, por për ministër.
Vokshi: S'ka lidhje fisi këtu. Ju duhet të keni reagim institucional.
Lleshaj: Do ishte shërbim publik po ta zbardhnim, por jo me deklarata të papërgjegjshme.
Salianji: Ministri i Brendshëm mund të jetë shumë i mire si klerik dhe si prinç, por jo si zbatues i ligjit. Sot qytetarët kanë kuptuar se Ministria e Brendshme ka shkelur ligjin me studentët.

gjihtë të pranishmit disa pamje nga incidentet e ndodhura ndërmjet studentëve dhe policisë. "Nuk kam ardhur për të parë film këtu. Unë kam ardhur të përgjigjem pyetjeve. Nuk bëj komentimin e videove", - reagoi Lleshaj ndaj kësjaj video, ndërsa shtoi se forcat e Policisë së Shtetit janë angazhuar për mbarevajtjen e protestës së studentëve. I pranishëm në seancë edhe deputeti demokrat, Ervin Salianji i kërkoi shpjegim ministrit për ndërhyrjen e policisë brenda auditoreve të Universitetit, ndërsa e akuzoi atë se nga një gjeneral është kthyer në një ushtar i Ramës. "Ne ju kemi thirrur në mënyrë specifike, as Hekuran Isai nuk ka guxuar ta bëjë këtë, a e keni

Ministri gjerman takon Ruçin e Ballën: Ju mbështesim për anëtarësimin në BE

Gjatë vizitës zyrtare në Gjermani, kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi dhe kreu i Grupit Parlamentar të PS, Taulant Balla u takuan me ministrin e Shtetit për Çështje të BE, Michael Roth. Gjatë këtij takimi, Ruçi e vuri theksin te mbështetja e qeverisë gjermane dhe Kancelares Merkel në procesin e vendimmarrjes së Vendimit të Këshillit Europian për rekomandimin për çeljen e negociatave në qershor 2019. "Çelja e negociatave të anëtarësimin është beteja kryesore e Kuvendit, qeverisë dhe gjithë qytetarëve shqiptarë, të cilët janë unanimisht në mbështetje të këtij procesi", nënvizoi Kryetari i Kuvendit, duke shprehur bindjen se Gjermania do të vazhdojë të japë mbështetjen e saj, duke njohur e vlerësuar përpjekimin e Shqipërisë në arritjen e objektivave të çeljen e negociatave. Njëpërmjet ministrit Roth, kreu i Kuvendit falënderoi qeverinë gjermane për vlerësimin se Shqipëria është një garanci për paqen dhe stabilitetin në Ballkan dhe se luan një rol thellësisht pozitiv në kontekstin rajonal. Nga ana e tij, ministri Roth vlerësoi arritet e reformës në drejtësi, si një reformë e suksesshme dhe vlerësoi partneritetin e ngushtë midis të dy vendeve në funksion të procesit të integritimit europian te Shqipërisë.



Mazhoranca ka votuar në parim ndryshimet në rregullore, rikthehet "imuniteti"

Xhafaj: Deputetët janë kthyer në kartonë dhe pa integritet

"Duam ta fusim në këshill që të mos përdoret kartoni"

Mazhoranca miratoi dje në parim, me shumicë votash, draftin e ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit, ku ndërmjet të tjerave propozohet edhe rikthimi i "imunitetit" të deputetëve në rastin e kërkesës për arrestim apo procedim të deputetit. Ndonëse në seancën e shkuar, kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, u shpreh i hapur për ta riparë këtë pikë sipas sugjerimeve që mund të kishte opozita, dje deputetët e majtë me forcën e kartonëve kanë votuar draftin siç ishte në gjendjen fillestare, përfshi këtu të gjitha propozimet e ardhura nga grupet parlamentare si dhe organizmat që asistojnë vendin tonë në forcimin e demokracisë.



Komisioni i Ligjeve gjatë mbledhjes së djeshme

RAMA TAKON MBREJTIN SAUDIT: PRITJE MIQËSORE

Kryeministri Edi Rama ndodhet në një vizitë zyrtare në Arabinë Saudite, ku ka zhvilluar edhe një takim me mbretin Salman ibn Abdulaziz Al Saudi. Vetë z.Rama zbardhi detajet e takimit, ndërsa e cilësoi pritjen e mbretit të Arabisë Saudite si shumë miqësore. "Në pritjen shumë miqësore të mbretit Salman ibn Abdulaziz Al Saudi, ku pas drekës zyrtare u nënshkruan disa marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi", shkruan kryeministri Edi Rama krahas videos.

XHAFAJ

"Duhet të përqendrohet te roli i deputetit në procesin ligjvënës dhe në marrëdhëniet me zgjedhësit. Këtë do dëshiroja të shihja. Ndryshimet e bëra ndër vite kanë zbehur rolin e deputetit, që janë shndërruar në kartonë se sa në integritetin e tyre".



PD: Ushtarët e Ramës refuzuan komisionin hetimor për Tahirin

Mazhoranca ka refuzuar gjatë ditës së djeshme të miratimit edhe kërkesën e re të Partisë Demokratike për ngritjen e një komisioni të ri hetimor për të hetuar trafikun dhe kultivimin e drogës gjatë kohës që Ministrinë e Brendshme e drejtonte Saimir Tahiri. Shumica socialiste ka kërkuar më shumë kohë për t'u njohur me kërkesën e re të demokratëve, ndaj dhe nuk kanë pranuar që ta miratojnë në mbledhjen e djeshme. Menjëherë pas kësaj, kryetari i grupit parlamentar demokrat, Edmond Spaho, ka dalë në një konferencë për mediat ku tha se Edi Rama ka zvarritur hetimet ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahirin, si në prokurori, ashtu edhe në parlament. "Partia Socialiste dhe Edi Rama kanë ndërtuar një skemë për të zvarritur hetimet ndaj Saimir Tahirin me shpresën për ta shpëtuar atë nga burgu dhe më pas edhe veten e tij. Sot, ushtarët e Edi Ramës në Konferencën e Kryetarëve refuzuan ngritjen pa vonesë të komisionit hetimor për Saimir Tahirin. Në përpjekje për ta zvarritur sërish të drejtën kushtetuese të opozitës për të kontrolluar qeverisjen, që në këtë rast është bashkëqeverisje me bandat, Partia Socialiste kërkoi kohë për t'u njohur me kërkesën tonë për komision hetimor", - tha Spaho.

DISKUTIMET

Relatorja Vasilika Hysi u shpreh se dokumenti përmbledh një sërë propozimesh, që sjellin për miratim të mënyrës së funksionimit të Kuvendit në drejtim të aspektit legjislativ dhe që përforcojnë etikën parlamentare. "Rregullorja është miratuar në vitin 2004. Ndërkohë që nga 2004-a e në vijimësi janë miratuar një sërë ligjesh dhe ka disa ndryshime kushtetuese, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në veprimtarinë e parlamentit", - argumentoi Hysi. Ndërkohë që opozita ripërsëriti kërkesën për ta bërë diskutimin për ndryshimet në rregullore në Këshillin e Legjislacionit, socialistët i kujtuan bojkotin e këtij organi nga ana e demokratëve. Ajo e quajti deformim, shqyrtimin e këtij projektvendimi në komisionin e ligjeve, duke deklaruar mungesën e kompetencës së këtij të fundit për shqyrtim. "Duam ta fusim në këshill në mënyrë që mazhoranca të mos përdorë forcën e kartonit. Plotësoni kërkesën tonë, hiqni dorë, sepse përgjirimet me fjalë nuk çojnë askund", - tha deputeti demokrat, Enkelejd Alibeaj. Kjo kërkesë e opozitës u hodh poshtë me 5 vota pro dhe 10 vota kundër të PS-së. Kjo bëri që deputetët e djathtë të largohen nga salla, ndërsa mazhoranca vijoi e vetme diskutimin e këtij projektvendimi.

XHAFAJ

Por, edhe brenda vetë mazhorancës nuk ishin të gjithë dakord me propozimet e bëra. Ish-ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj është treguar skeptik mbi

PROPOZIMET E PS

- Në nenin 13, pikat 3, 4, 5 dhe 6 ndryshojnë si më poshtë: Këshilli shqyrton kërkesën e prokurorisë për dhënie e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin, heqjen e lirisë në çfarëdo lloj forme, ushtrimin e kontrollit personal apo të banesës së një deputeti. Procedura e detajuar parashikohet në nenin 118 dhe 119 të kësaj rregulloreje. Këshilli shqyrton të gjitha çështjet e vlefshmërisë së mandatit të deputetit që lidhen me fillimin dhe mbarimin e ushtrimit të mandatit, heqjen dorë nga mandati, kushtet e papajteshmërisë sipas nenit 70 të Kushtetutës, mungesën pa arsye për më shumë se 6 muaj rresht në Kuvend, dënimin me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Pas përfundimit të shqyrtimit, këshilli paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 2 javëve. Këshilli shqyrton rastet e pazgjedhshmërisë sipas nenit 69 të Kushtetutës si dhe bën verifikimin e mandatit të deputetit, i cili zgjidhet gjatë legjislaturës kur krijohet vakancë, mbi bazën e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pas përfundimit të shqyrtimit, këshilli paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 2 javëve. Këshilli, si rregull, mbledhet në mënyrën e parashikuar nga kjo rregullore për komisionet e përhershme, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.
- Neni 118 riformulohet si vijon: **Autorizimi për procedim**
 1. Kërkesa për të autorizuar takimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrollit personal ose të banesës, i paraqitet kryetarit të Kuvendit nga prokurori. Kërkesa përmban një relacion të arsyetuar dhe të shoqëruar me provat që mbështesin kërkesën.
 2. Kryetari i Kuvendit ia dërgon kërkesën dhe dokumentet shoqëruese menjëherë për shqyrtim Këshillit për Rregullore, Mandatat dhe Imunitetin si dhe vë në dijeni Kuvendin dhe deputetin.
 3. Kryetari i Kuvendit pas konsultimit me këshillin, cakton dy raportet për çështjen, respektivisht nga shumica dhe opozita parlamentare.
 4. Deputeti, ndaj të cilit kërkohet autorizimi për procedim, i vihet në dispozicion kërkesa dhe dokumentet që e shoqërojnë atë, si dhe i bëhet e ditur koha kur Këshilli për Rregullore, Mandatat dhe Imunitetin do të fillojë shqyrtimin e kërkesës.
 5. Në mbledhjen e Këshillit për Rregullore Mandatat dhe Imunitetin merr fjalën prokurori, i cili paraqet arsyet e kërkesës drejtuar Kuvendit. Pas paraqitjes së kërkesës, çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë t'i drejtojë pyetje prokurorit.
 6. Pas përgjigjeve të pyetjeve, kryetari i Kuvendit, i jep fjalën deputetit ndaj të cilit kërkohet autorizimi për procedim. Deputeti dhe ose përfaqësuesi i tij ligjor ka të drejtë të paraqesë në Këshill, me shkrim ose me gojë, shpjegimet dhe vërejtjet e tij rreth çështjes. Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë t'i drejtojë pyetje deputetit.

Njoftim për shitje me ankad të II

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k në datë 01.02.2019 ka shpallur ankandin e dytë të pasurisë të paisë debitorë Shoqëria "ARNI" sh.p.k. Paeuria që del në ankad të dytë përbëhet nga:

"Apartamenti", nr Nr pasurie 69/11/ND +1-14 ndodh Rr "Dodona", Hyrja nr.1, Kati 1, 3Ap 14, Oriktum e regjistruar në ZVRRP- Vitore, Z K Nr.2832, volumni 16, faqe 120, me sipër 43 m².

Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 1.344.000 lekë. Ankandi do të zhvillohet në datë 04.03.2019 në orën 15:00 në selinë Bul "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5. Kontakt 0672062543, Iir_ dervishaj@yahoo.com, faqen WEB www.powerjustice-all.com

OPOZITA PROTESTA

PD mbledh grupin parlamentar: Betejë me qytetarët dhe në parlament

Basha: Qeveri tranzitore, Edi Rama ka afat deri në 15 shkurt

"Të ikë nga karrigia që i falën kriminelët"

Aksioni opozitar ishte dje në qendër të mbledhjes së grupit parlamentar të demokra-tëve. Krahas takimeve me elektora-tin në bazë, në prag edhe të protestës së 16 shkurtit, opo-zi-ta do ta vijojë betejën politike edhe në parlament. Ata vendosën që edhe sot do të foku-sohen tek aferat e qeverisë, ku sërish do të kërkojnë krijimin e një qeverie tranzitore që t'u hapë rrugë zgjedhjeve të lira. Kreu i PD, Lulzim Basha, më pas vijoi takimet në kuadër të protestës së 16 shkurtit. Basha ishte në Vorë, ku u takua me qytetarë të ndry-shëm dhe u njoh me probl-em-atikat e tyre. Kryedemokrati tha se Rama ka ngritur kam-hi-kun ndaj qytetarëve duke rritur taksat, ndërsa e vetmja mënyrë është rezistenca popu-llore për të dalë nga kriza ekonomike. "Problemi është se ai ka prerë bukën e gojës. 1 në 10 shqiptarë ha vetëm njëherë në ditë. Edi Rama nuk e ka biznesin në tepsi, në tepsi ka 2 miliardë euro të vjedhu-ra. Duhet të ndalen politikat që e kanë shkaktuar gjendjen e mjerë të shqiptarëve. Ne kemi planin për biznesin. Do ju mbështesim si sipërmarrës dhe punëdhënës. Biznesi i madh nuk është futur në tepsi. 2 miliardë euro që i ka në tepsi, nuk i kthen në investime. Ne si opozitë ju ofrojmë alternativën, nuk kemi asnjë mjet tjetër për ta zgjidhur. Ju ftoj në 16 shkurt ta zgjidhni si popull, me rezistencë popu-llore. Na duhet të këpusim lidhjet e politikës me krim-in dhe këte mund ta bëjë vetëm populli", - tha Basha. Po dje, kreu i PD-së ishte në mbështetje të protestës së banorëve që preken nga projekti i "Un-azës së Madhe". Ai i ftoi ata dhe të gjithë qytetarët e tjerë që i bashkohen protestës së 16 shkurtit. Sipas Bashës, Rama ka afat deri në 15 shkurt që t'i japë zgjidhje krizës me largimin e tij. Kreu i PD-së kërkoi zgjedhje të parakohshme dhe qeveri tranzitore, ose në të kundërt pas 16 shkurtit, fjalën do ta kenë vetëm qytetarët. "Deri në 15 shkurt të largohet nga karrigia që i kanë falur kriminelët, t'i hapë rrugë zgjidhjes politike, qeveri tran-zi-tore, parlament të qytetarëve, qeveri të qytetarëve. Përndry-shje prej 16 shkurtit e tutje ka vetëm një forcë që vendos, forca e qytetarit të bashkuar", u shpreh z.Basha. "Protesta tek Unaza e Re është një shem-bull i jashtëzakonshëm i kurajo-s dhe qendrësës, që u tregoi shqiptarëve rrugën për t'u për-balluar me padrejtësitë. Forca e qytetarëve të bashkuar do të vendosë edhe më 16 shkurt. Projekti i Unazës së Re ka vdekur, por nuk duan ta kal-lin, sepse kanë marrë ka-pa-rin në miliona euro. Edi Rama nuk është kryeminis-tri i shqiptarëve, por i hajdutëve, oligarkëve, krimi-nelëve, peng, shërbëtor dhe ortaku i tyre", shtoi ai.



Mbledhja e Grupit Parlamentar të PD-së

Presidenti: Uniteti SHBA-BE të reflektohet në dialogun Kosovë-Serbi

Meta në SHBA: Zgjidhja, integrimi i Ballkanit, jo ndryshim kufijsh

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, në vijim të vizitës së tij në Uashington D.C, mori pjesë dje në Forumin "Transatlantic Leadership Network" të organizuar në Kongresin Amerikan me temë "Ballkani Perëndimor: Si të kapërcehen pengesat në rrugën drejt Bashkimit Europian". Presidenti Meta gjatë fjalës së tij theksoi ndër të tjera se: "Ndryshimi i vetëm i kufijve, për të cilin duhet të punojmë ditë e natë në rajonin tonë është zgjerimi i plotë i kufirit evropian në Ballkanin Perëndimor. Shpresoj që investitorë më seriozë evropianë të sjellin kapitalet e tyre në sektorët strategjikë në ekonominë tona, me garancinë se do të gëzojnë përparësi dhe mbështetje të plotë, ndërkohë që do të na ndihmojnë në ndalojmë largimin e popullsisë së vendeve tona", - u shpreh Presidenti Meta. Nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Ilir Meta ritheksoi se, "ndryshimi i vetëm i kufijve për të cilin duhet të punojmë ditë e natë në rajonin tonë është zgjerimi i plotë i



kufirit evropian në Ballkanin Perëndimor". Presidenti Meta gjatë fjalës së tij theksoi ndër të tjera: "Politikat e hartuara evropiane për Ballkanin Perëndimor duhet të forcojnë sigurinë, institucionet dhe ekonominë tona. Duhet të jenë të zbatueshme, transparente dhe të synojnë rritjen e besimit të qytetarëve, plotësisht të përafëruara me vlerat dhe standardet evropiane. Bashkimi Evropian nuk duhet të gabojë që të bëjë kompromise në këtë orientim, përkundrazi duhet të ruajë përqendrimin e vet të çështjet thelbësore të proceseve tona përkatëse. Ndryshimi i vetëm i kufijve, për të cil-

in duhet të punojmë ditë e natë në rajonin tonë është zgjerimi i plotë i kufirit evropian në Ballkanin Perëndimor!", - u shpreh Meta. Presidenti vuri në dukje se Procesi i Berlinit asnjëherë nuk u hartua me synimin për të zëvendësuar zgjerimin evropian, por u ideua si një mekanizëm nxitës për investime më thelbësore evropiane, si dhe bashkëpunim në rajonin tonë. Thellimi dhe zgjerimi evropian kanë ndodhur krahas për krahas, pa marrë parasysh dyshimet apo hezitimet, të cilat kanë qenë gjithmonë të pranishme", deklaroi z.Me-ta. Gjatë fjalës së tij në Forumin "Transatlantic Leadership Network", Meta foli edhe për liberalizimin e vizave në Kosovë. "Do të doja gjithashtu të ndaleshim e të përqendroheshim të vendimi i mençur dhe i guximshëm i BE-së për ta zbatuar regjimin e lëvizjes pa viza për qytetarët e Kosovës sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në përgjithësi, procesin e shpejtë të anëtarësimit për mbarë rajonin", - deklaroi kreu i shtetit Meta.

KREU I PD-SË
"Edi Rama nuk e ka biznesin në tepsi, në tepsi ka 2 miliardë euro të vjedhura. Duhet të ndalen politikat që e kanë shkaktuar gjendjen e mjerë të shqiptarëve. Ne kemi planin për biznesin. Do ju mbështesim si sipërmarrës dhe punëdhënës. Biznesi i madh nuk është futur në tepsi".

Mediu në SHBA: Të forcojmë marrëdhënien ushtarake me SHBA-të

Në Senatën amerikanë u mbajt një forum për sigurinë në Evropën Juglindore, me pjesëmarrjen e zyrtarëve dhe parlamentarëve nga 17 vende të Evropës. Përfaqësues nga Shqipëria ishin Presidenti Meta, Majko Mediu dhe Gjyknuri. Mediu falënderoi senatorin Inhofe dhe kongresmenin Aderholt për mbështetjen në organizimin e këtij forumi të 4-të në Senatën amerikanë. "Ne besojmë se partneriteti i vendeve të rajonit tonë me Shtetet e Bashkuara ka një rëndësi jetike për demokracinë, për popujt tanë dhe të ardhmen në Evropë e në NATO. Është e një rëndësie parësore për ne që të forcojmë marrëdhënien ushtarake me SHBA-të", - tha Mediu.



Tabaku: Bizneset po falimentojnë, protestoni në shesh për xhepin tuaj

Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku, pa dje nga afër disa biznese në kryeqytet. Tabaku theksoi se shumë prej bizneseve s'kishin bërë asnjë shitje, edhe pse ishte ora 12:00 e paradites. Sipas saj, edhe marketet ishin në krizë të thellë. "Gjatë vizitës në një numër të madh dhe të shumëllojshëm biznese, vëreja se shumica e tyre ndonëse ora po afroonte 12, nuk kishin nisur ende të bënin shitjet e para. Qytetarët nuk kanë para të blejnë produkte, nuk konsumojnë, pasi të gjitha të ardhurat u shkojnë në taksat, çmimin e energjisë, tarifën e ujit, kostot e transportit. Edhe marketet ishin në krizë të thellë sa u takon konsumatorëve, dëshpërimi i tyre që i madh", tha Tabaku. Ajo u bëri thirrje qytetarëve që të dalin më 16 shkurt në shesh dhe të protestojnë për "xhepin e tyre". "Ata që nuk e duan konsumin, që duan një individ të varfër, një shqiptar që nuk konsumon, por që vetëm taksohet për t'u pasuruar vetëm lagjia e mazhorancës, janë ata që sot qeverisin. Në 16 shkurt, eja në shesh për të protestuar për xhepin tënd. Eja në shesh për të protestuar për taksat e larta. Për tarifën e larta. Eja në shesh për një Shqipëri më të mirë dhe për një shqiptar më pak taksat", tha ajo.



32 të arrestuarit e "Rruga e gabuar", viza e pasaporta false për në SHBA e BE

"Të kalojë nga Kakavija", "është bërë keq", përgjimet e grupit të trafikantëve

Klodiana Lala

Bisedat e "kokës" që është në arrati, Dritan Gramozi

Në dosjen e Prokurorisë, siguruar për "Bal kanWeb" shpjegohet se si funksiononte grupi me 32 të arrestuar në operacionin "Rruga e Gabuar" që siguronin viza e pasaporta false për të mundësuar kalimin e paligjshëm drejt vendeve të BE, Kanadasë, SHBA, por edhe drejt Mbretërisë së Bashkuar.

Bëhet me dije se 32 të arrestuarit janë pjesë e të njëjtit rrjet të goditur edhe e të njëjtit pranverën e vitit 2018, ndërsa aktiviteti i tyre është i shtrirë në kohë dhe hapësirë. Bazuar në hetimet e kryera nga Prokuroria për Krime të Rënda, nisja bëhej me linjat e udhëtimit të falsifikuara bëhej nga Republika e Shqipërisë, Mali i Zi, Italia, Greqia, Franca dhe Norvegjia.


Ndërsa në funksion të këtij hetimi, janë dokumentuar disa episode ku personat e mësipërm kanë falsifikuar dokumente të udhëtimit dhe kanë dhënë ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit të disa shtetaseve.

Dritan Gramozi, i arratisur, i njohur edhe si koka e këtij grupi del nga përgjimet se ishte personi që kryente transportin. Nga përgjimet ai del se organizonte kalimin e klandestinëve drejt Greqisë dhe iu jepte direktiva pjesëtarëve të tjerë të grupit se si të bënin kalimin.

Në datë 12.01.2018 në mëngjes në një bisedë të përgjuar Dritan Gramozi komu-



Dritan Gramozi



REAGIMI I SHBA

Ambasada e Shteteve të Bashkuara përgëzon Policinë e Shtetit dhe zyrën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda për suksesin e operacionit "Rruga e gabuar", i cili solli arrestimin e 32 qytetarëve shqiptarë të përfshirë në kalimin e paligjshëm të njerëzve përtej kufirit dhe prodhimin e dokumenteve të falsifikuara.

nikon me shtetasin Rezart Hoxha
 R: Alo
 D: Alo, hë vëlla
 R: E këtu jam o, ku je ti?
 D: E ja do nisem, prandaj të mora
 R: E ja të bëj një telefon unë që t'më dëgjojnë ata, Uester Junion me ça do t'i

dërgojnë
 D: O vlla, po pak shpejt se s'kam kohë
 R: Në rregull, hajt
 Po ky shtetas rreth mesditës flet me një tjetër numër celulari dhe bisedon se si mund të kalonte kufirin një tjetër shtetas
 D: Hë

Nr: O Byrazier
 D: Hë vëlla
 Nr: Po t'kaloi nga Rinasi për Athin
 D: Po nga Rinasi ;mos i ashtu atëja
 Nr: Ua
 D: Mos i thonë e ke të mbushur tre muorshin se unë e hodha në sistem, është

brenda me afatin ai tremujorshin
 Nr: O le të kalojë këtu na Kakavija, mbase si thënë gjë hajde
 D: Jo ore lëre, se dëgjo Tanin është bërë keq unë i shikoj ditë për ditë
 Nr: Uah
 D: E
 Nr: Vetëm andej nga ajo ë?
 D: E
 Në përgjime del edhe emri i shtetasit Leonard Markaj, i cili komunikoi në telefon me një tjetër numër tjetër të përgjuar. Në bisedat që bëjnë flasin për njerëz që kalojnë në kufi dhe për korrupsionin e personave që janë përgjegjës për kalimin në pikat e kontrollit.

32 të arrestuarit janë pjesë e të njëjtit rrjet të goditur edhe e të njëjtit pranverën e vitit 2018, ndërsa aktiviteti i tyre është i shtrirë në kohë dhe hapësirë. Bazuar në hetimet e kryera nga Prokuroria për Krime të Rënda, nisja bëhej me linjat e udhëtimit të falsifikuara bëhej nga Republika e Shqipërisë, Mali i Zi, Italia, Greqia, Franca dhe Norvegjia.

B: Po ku je o ku je?
 Leo: Kam pas një problem ashtu ta them
 B: Mos ma thuaj në telefon po s'është për tu thënë
 Leo: E nuk ta them në telefon, e s'kam lëvizur unë. Ta thashë kisha një problem e s'kam lëvizur: Po andej nesër kush është?
 B: Nesër është Jorgaqi
 Leo: A Jorgua është nesër
 B: Kristinaqi
 B: Me Nika i kaloi du veta, ikën ata
 Leo: Se nuk para të lë Kristina halea, nuk para të lë. Pse ky lë ky kokëbardhi?
 B: E të lë ai kokëbardhi nuk është i keq ai
 Leo: Edhe Jorgo nuk është bërë i keq tani jo, i dhashë kafë unë, e qirasa me kafë të thashë unë.

United Nations Development Programme

VACANCY ANNOUNCEMENT

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.
Post Title: Project & Policy Specialist
Duty station: Tirana
Duration of Assignment: until 31 December 2019
Type of Contract: Service Contract

Educational Background: Master's degree in public administration, public policy, economics, development or other related fields

Work Experience: 7 years or more of relevant experience in or contributing to public administration reform through key role within public administration or through project/programme support services, 3 years demonstrated working experience and/or knowledge in the fields of public policy analysis and/or research is an advantage. Work exposure to areas related to public administration capacity building at central and local level, economic development or similar is an advantage. Work experience or interaction with international organizations environment would be an asset.

Demonstrated understanding of Albania's local governance system.
 Experience in integrated governance programming / institutional development.

Tentative Starting Date: 01 March 2019
Deadline for Application: 19/02/2019
Job Description: Available at UNDP site: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>

Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.

United Nations Development Programme

VACANCY ANNOUNCEMENT

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.
Post Title: Project Specialist on Integrity and Anticorruption
Duty station: Tirana
Duration of Assignment: until 31 December 2019
Type of Contract: Service Contract

Educational Background: Post graduate degree in Political Science, Public Administration, Public Policy, Law, Sociology, Development Studies or other relevant fields

Work Experience: A minimum of 5 years working experience public institutions with regard to reforms in local governance, decentralization and institutional development. 3 years of relevant professional working experience in the area of anti-corruption, public ethics and integrity (is an advantage); Experience with organization of national and / or international activities in the field of local governance and democratization; Experience in working with Local Government Units on issues of public ethics, integrity and anticorruption is preferable

Demonstrated understanding of Albania's local governance system.
 Experience in integrated governance programming / institutional development.

Tentative Starting Date: 01 March 2019
Deadline for Application: 19/02/2019
Job Description: Available at UNDP site: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>

Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.

Plani për ndërtimin e kompanisë kombëtare të fluturimit, "Air Albania" vishet me dyshime. "CH Aviation", një portal zviceran i specializuar për zhvillimet në industrinë e aviacionit, shkruan se projekti "Air Albania" është lënë në harresë, ndërkohë që avionët e siguruar nga "Turkish Airlines" janë rikthyer në Turqi. Ideja për krijimin e kompanisë kombëtare të fluturimeve u njoftua për herë të parë në korrik të vitit 2017, si një nismë e përbashkët e kryeministrit Edi Rama dhe presidentit turk Erdogan. Nisma u zyrtarizua një vit më vonë.

Portali zviceran: Avionët janë rikthyer në Turqi "Air Albania" vishet me dyshime

PROJEKTI

Projekti "Air Albania" është lënë në harresë, ndërkohë që avionët e siguruar nga "Turkish Airlines" janë rikthyer në Turqi. Ideja për krijimin e kompanisë kombëtare të fluturimeve u njoftua për herë të parë në korrik të vitit 2017, si një nismë e përbashkët e kryeministrit Edi Rama dhe presidentit turk Erdogan.

Në qershor të vitit 2018 u krijua kompania "Air Albania" me 3 aksionerë: "Turkish Airlines", "MDN Investment" dhe "Albcontrol". Menjëherë pas krijimit, shefi i qeverisë

shqiptare dha edhe afate konkrete se kur shqiptarët do të udhëtonin me kompaninë e tyre ajrore. Belinda Balluku, ministria aktuale e Infrastrukturës, në atë

kohë drejtoreshë e "Albcontrol"-it, premtoi se më në fund shqiptarët do të shpëtonin nga çmimet e kripura të biletave që paguajnë aktualisht. Por, plani i qeverisë re-



zultoi optimist, të paktën sa u përket afateve. Zyrtarisht, autoritetet shqiptare thonë se kompania është ende në proces për të marrë lejet e nevojshme nga organizmat

ndërkombëtarë dhe se projekti po ecën sipas planit. Por, zërat skeptikë mbi fatin e kompanisë janë shtuar ndjeshëm, jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij.

Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara

VKM/ 200 pronarët që marrin tapinë për tokën në 5 qarqe

Ndërtimet pa leje, certifikata për truallin, brenda 5 ditëve

Qeveria miratoi dje kalimin e së drejtës së pronësisë për parcelat ndërtimore ku janë ndërtuar objekte pa leje. Janë në total 200 pronarë që marrin certifikatën e pronësisë. Përfutuesit janë në pesë qarqe, në Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë dhe Dibër dhe do të marrin certifikatën e pronësisë brenda 5 ditëve.

VENDIMI

Këshilli i Ministrave vendosi dje miratimin e kalimit të së drejtës së pronësisë në favor të subjekteve përfutuese për 200 parcela ndërtimore të objekteve të legalizuara, që preken prej tyre, sipas shtojçës që i bashkëlidhet këtij vendimi. Në vendim mësohet se numri i parcelave ndërtimore për të cilat miratohet kalimi i pronësisë për qarkun Dibër (ZVRPP Dibër, Bulqizë, Mat), është 63, me sipërfaqe të përgjithshme 15 278 m². Për qarkun Lezhë, ku përfshihen ZVRPP Lezhë dhe Kurbin, numri i parcelave ndërtimore është 15, me sipërfaqe të përgjithshme 4 781 m² dhe për qarkun Shkodër, numri i parcelave ndërtimore është 3, me sipërfaqe të përgjithshme 614 m². Në qarkun Tiranë janë 61 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme 17 639 m² dhe për qarkun Durrës, numri i parcelave ndërtimore është 58, me sipërfaqe të përgjithshme 21 767 m². Këshilli i Ministrave vendosi që Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Dibër, Bulqizë, Mat, Lezhë, Kurbin, Shkodër, Tiranë, Durrës të regjistrojnë brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kalimin e së drejtës së pronësisë së parcelave ndërtimore dhe hipotekën ligjore mbi to, në përputhje me përcaktimet e pikave 15 e 16, të vendimit nr.1095, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALU-IZNI-t dhe ZQRPP-së, si dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara". Ndërkohë, ngarkohen Ministria e Drejtë-



Foto ilustruese

sisë, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të

Paluajtshme dhe Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të përmendura në pikën 3, për zbatimin e këtij vendimi.

SIPËRFAQET

Nuk mund të legalizohet më shumë se 3-fishi i bazës së objektit të ndërtuar pa leje. Në rast se një person ka ndër-

tuar 50m2, do të marrësh 150 metra dhe kjo logjikë do të ndiqet për të gjitha ndërtimet. Objektet tregtare që kanë bërë ndërtime psh., 500 metra do të marrin 1500 metra, por do ta paguajnë me çmim tregu. Ndërsa për llogaritjen e vlerës së parcelës është marrë gjysma e vlerës së tregut.

KALIMI I PRONËSISË

Në vendimin e Këshillit të Ministrave përcaktohet që kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objektit pa leje bëhet sipas dispozitave të Kodit Civil. Në rastin e ndërtimeve me funksion banimi, si rregull sipërfaqja e parcelës për të cilën

miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë duhet të jetë deri në masën e trefishit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo më e madhe se 500 (pesëqind) m². Për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik zbatohet vetëm kriteri i trefishit të sipërfaqes së bazës së ndërtimit. Kur për shkak të përmasave ose konfiguracionit të parcelës ndërtimore krijohen sipërfaqe të lira, që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, ato i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR I SHOQERUAR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shtypja e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar i shoqeruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 54,345,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibërës, Kompleksi "Hallit", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, për numër tregtarë në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shtypje e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 11 Mars 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Balluku: Prioritet, ndërlidhja me rajonin dhe efienca e energjisë


Ndërlidhja me rrjetet rajonale të energjisë dhe krijimi i një tregu konkurrues, rritja e penetrimit të kapaciteteve të gjenerimit të energjisë nga burime të rinovueshme, promovimi i masave për efiençën e energjisë dhe masat për mbrojtjen e klimës janë disa nga prioritetet Shqipërisë, e cila këtë vit mban presidencën e Traktatit të Kartës së Energjisë, ku bëjnë pjesë 53 shtete. Prioritet janë bërë të ditura nga ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, e cila priti në një takim sekretarin e përgjithshëm të këtij traktati. "Sot kam pasur nderin të pres në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë sekretarin e përgjithshëm të Energy Charter Urban", Rusnák, i cili bëri një vizitë në Shqipëri për të më informuar më tej përpara i përket presidencës që Shqipëria ka gjatë vitit 2019 në Energy Charter". Përfitova nga rasti për t'i treguar të gjitha investimet dhe gjithçka që është bërë në fushën e energjisë". Nga ana e tij, sekretari i përgjithshëm u shpreh se vendi ynë ka potencial të madh për të luajtur një rol të rëndësishëm në arritjen e një niveli të përgjithshëm të energjisë së gjelbër dhe të rinovueshme në sistemin energjetik të Ballkanit. Gjatë vitit 2019 Shqipëria do të organizojë dy takime të mëdha ndërkombëtare në fushën e energjetikës, siç janë Forumi ndërkombëtar i Efiençës së Energjisë dhe Konferenca Ministeriale e Energy Charter, që do të ketë në fokus diversifikimin e burimeve energjetike.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë: Normat e interesit të kredive janë në nivelet më të ulëta historike

Sejko: Ekonomia në rritje, leku do të forcohet

Kërkesa agregate po rritet, sjell rritjen e prodhimit dhe punësimit

Monedha vendëse, Leku, do të vijojë të mbijetojë edhe në gjysmën e parë të këtij viti. Ekonomia shqiptare u rrit me 4.25% në tremujorin e tretë, e nxitur nga konsumi, eksportet dhe prodhimi i energjisë. Kërkesa agregate po rritet, çka do të sjellë edhe rritje të prodhimit dhe punësimit. Këto janë konstatimet dhe projektionet e Bankës së Shqipërisë për ekonominë shqiptare për vitin që lamë pas dhe për muajt në vijim. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, pohoi dje se kërkesa agregate po rritet, duke sjellë rritjen e prodhimit dhe punësimit, teksa politika monetare po jep kontribut pozitiv. "Efekti i mbijetimit të lekut do të jetë i pranishëm edhe gjatë 6 muajve të parë të 2019, por do të shuhet në pjesën e dytë të vitit", tha guvernatori në konferencën për mediat menjëherë pas mbledhjes së Këshillit të Mbikëqyrjes, ku njoftoi se norma bazë e interesit mbetet e pandryshuar, 1%. Banka vlerëson se informacioni i ri për ekonominë është në përputhje me parashikimet. Pozicioni ciklik i ekonomisë do të përmirësohet më tej - shtoi ai. Ekonomia shqiptare u rrit me 4.25% në tremujorin e tretë, e nxi-



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko

tur nga konsumi, eksportet dhe prodhimi i energjisë. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë shtoi: "Normat e interesit të kredive mbeten në nivelet më të ulëta historike, kurse kursi i këmbimit ka qenë i qëndrueshëm gjatë muajit janar". Ai foli edhe për një përmirësim të balancave në sektorin bankar, ku veçoi zbritjen e kredive me probleme në 11%.

KONFERENCA

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, në konferencën e mbajtur për shtyp dje në ambientet e Bankës së Shqipërisë foli mbi vendimmarrjen e politikës

monetare. Sipas tij, falë zhvillimeve pozitive ekonomike, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 1%. Guvernatori pohoi se monedha vendëse, Leku, do të vijojë të mbijetojë edhe në gjysmën e parë të këtij viti. "Efekti i mbijetimit të lekut do të jetë i pranishëm edhe gjatë 6 muajve të parë të 2019, por do të shuhet në pjesën e dytë të vitit", tha guvernatori në konferencën për mediat, menjëherë pas mbledhjes së Këshillit të Mbikëqyrjes, ku njoftoi se norma bazë e interesit mbe-

tet e pandryshuar. Guvernatori u shpreh se kërkesa agregate po rritet, duke sjellë rritjen e prodhimit dhe punësimit, teksa politika monetare po jep kontribut pozitiv. Sejko pohoi se gjatë tremujorit të tretë të vitit 2018-ritja ekonomike ka qenë 4.45%, e ndikuar nga rritja e eksporteve dhe prodhimit të energjisë elektrike. Po ashtu, ai sqaroi se ekonomia ka vijuar të rritet edhe gjatë tremujorit të 4, ndoshta edhe pse me një rritje pak më të ngadaltë. Sipas Sejkos, edhe presionet e brendshme dhe të jashtme inflacioniste po shkojnë drejt ekuilibrit.

Kursimet e shqiptarëve arrijnë në 4 miliardë euro

Euro është një monedhë mjaft e preferuar e kur simtarëve shqiptarë. Të dhënat e Bankës së Shqipërisë, që raportohen në monedhën përkatëse, bëjnë të ditur se depozitat në euro në fund të vitit 2018 arritën në 4 miliardë, me një rritje prej 10% me bazë vjetore, ose rreth 370 milionë euro më shumë. (Kjo rritje është shumë më e lartë se vlera e raportimit në lekë i depozitave në valutë, ku zgjerimi ishte minimal prej 1% për shkak të efektit që ka pasur zhvlerësimi i euros, që ra nga 133 lekë në fillim të 2008-ës në 123 lekë në fund të saj). Ky është niveli më i lartë i regjistruar ndonjëherë i kursimeve në monedhën e përbashkët. Shtimi i depozitave në euro në 2018-ën ishte shumë më i lartë krahasuar me vitin e mëparshëm, kur ato u rritën me vetëm 68 milionë euro. Në vitin 2018, rritja erdhi nga depozitat pa afat të individëve dhe nga kursimet e korporatave jofinanciare. Rreth 77% e depozitave në euro zotërohen nga individët, ku më të preferuarat janë ato me afat 1-vjeçar (35% e totalit të individëve). Megjithatë, në 2018-ën, preferencë kanë qenë depozitat rrjedhëse, të cilat kanë shënuar edhe rritjen më të madhe, ndërsa depozitat me afat 12-mujor kanë qëndruar pothuajse të pandryshuara. Të dhënat e tjera të Bankës së Shqipërisë, të publikuara në lekë për totalin e kursimeve, bëjnë të ditur se depozitat në valutë në fund të 2018-ës arritën në 53.9% të totalit, duke shënuar nivelin më të lartë historik.



Mister 6,6 mln USD, Fullani merr post në bankën e Malit të Zi

Ish-kreu i BSH, së Ardiana Fullani merr një post të rëndësishëm në bankën qendrore malazeze. Guvernatori i Bankës Qendrore të Malit të Zi Radoje Zugic dhe Bordi Drejtues i Bankës Qendrore të Malit të Zi, kanë miratuar krijimin e Bordit Këshillues të Bankës Qendrore të Malit të Zi me 11 anëtarë, pjesë e së cilit është edhe ish-Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Ardian Fullani. Vendimi për krijimin e këtij bordi është marrë që në muajin shtator 2018. Lajmi bëhet i ditur nga gazeta e njohur malazeze "Vejesti", e cila nuk rri pa përmendur faktin se Fullani u shkarkua dhe arrestua në Shqipëri në vitin 2014 për shkak të vjedhjes së 713 milionë lekëve nga Thesari i Shtetit. Përveç Fullanit anëtar i Bordit Këshillues mësohet të jetë edhe një profesor i Fakultetit të Ekonomisë në pension Mlladjen Sllivanacani, njëherësh xhaxhai i guvernatorit malazez Zugic. Ky i fundit nuk ka pranuar të përgjigjet për mediat nëse minohet besueshmëria e këtij insti-



tucioni për shkak të konfliktit të interesit që ka me një nga anëtarët dhe për shkak se anëtarë tjetër nga Shqipëria, Ardian Fullani rezultoi të jetë shkarkuar për shpërdorim detyre pas vjedhjes së një shume të konsiderueshme parashë në institucionin që drejtohte.

Pjesë e këtij bordi janë edhe ish-guvernatorja Milojica Dakic e cila u tërhoq në vitin 2016, profesori i Fakultetit të Ekonomisë në Podgoricë, Vesna Karad-ic, profesoresha e Fakultetit të Ekonomisë në Beograd Dejan

Soskic, dy ish-guvernatorë të Bankës Kombëtare të Maqedonisë Petar Goshëv dhe Dimitar Bogov si dhe themelesit e drejtorit i Institutit Amerikan Adige Isak Adizes, i cili është gjithashtu kryetar i bordit këshillues. Sipas vendimit mbi formimin e Bordit Këshillues, për të cilin "Vijesti" ka njohuri, ky organ, monitoron tendencat bashkëkohore në fushën e politikës monetare dhe stabilitetin financiar në nivel global dhe në veçanti efektet e tyre të mundshme në sistemin financiar të Malit të Zi.

Progresi drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian do të nxisë profilin e borxhit sovran të vendeve të Ballkanit Perëndimor duke forcur institucionet, konkurrueshmërinë si dhe infrastrukturën", thotë agjencia e vlerësimit të kreditit "Moody's" në një raport të publikuar së fundmi, të siguruar ekskluzivisht nga "Scan". Por, agjencia, pasi jep lajmin e mirë, nuk ngurron të bëjë edhe një parashikim disi të zymtë, duke projektuar një shtyrje në procesin e anëtarësimit të të 6 vendeve në union. "Kjo - thotë 'Moody's' - është rrjedhojë e sfida-ve politike komplekse në rajon që do të ndërpresin implementimin e reformave të kërkuara për procesin e anëtarësimit. Borxhi sovran në vendet e Ballkanit Perëndimor do të marrë një shtyesë nga procesi i anëtarësimit në union. Përfitimet kryesore ekonomike do të bryojnë nga investimet në infrastrukturë dhe përmirësimi i konkurrueshmërisë", - thotë Evan Wohlmann, zv.president i "Moody's", i cili është njëkohësisht bashkautor i raportit në fjalë. Ndër të tjera, raporti nënvizon faktin se rregulli-

"Moody's": Do të rrisim notën e borxhit të Shqipërisë



mi drejt Bashkimin Europian do të forcojë edhe institucionet kryesore fiskale dhe monetare të këtyre vendeve, përfshirë këtu bankat qendrore. Ndër të tjera, ky proces do të forcojë klimën e dobët të biznesit si dhe nxisë sektorin privat në rajon, duke përmirësuar rritjen potenciale. Financimet nga Bashkimi Europian do të ndihmojnë duke ngushtuar deficitin e lartë të rajonit në infrastrukturë, forcur sigurinë energetike dhe sidomos stimulojnë tregtinë ndërajonale. Gjithsesi, dinamika politike brenda këtyre vendeve, por edhe mes tyre do të ngadalësojë

përgatitjet si dhe hapin e reformave, nënvizon agjencia. Raporti i "Moody's" vjen në një moment kritik në rajon, kur tensionet mes Kosovës dhe Serbisë janë në majë, në një kohë që Maqedonia ka zgjidhur problemën e saj madhor dhe po përgatitet të anëtarësohet në NATO, si dhe vetëm pak muaj përpara hapjes së negociatave mes Brukselit dhe Shqipërisë e Maqedonisë. Rritja e notës së borxhit sovran të Shqipërisë nga "Moody's", që është një prej tri agjencive kryesore të vlerësimit të kreditit në botë, përthehet në kosto më të ulëta huamarrjeje për qeverinë shqiptare.

Shtyhet vendimi, gjykata kërkoi dokumente që prokurorët s'i kishin

Zgjatja e hetimeve, Tahiri: Prokuroria s'di si ta mbyllë, secili do të marrë faturën që i takon

DEKLARATA

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, deklaroi dje se nuk e ka humbur durimin dhe do presë vendimin e prokurorisë dhe gjykatës dhe se çdo njeri merr faturën që i takon. "Di të them që nuk e kam humbur durimin, unë do të pres deri në fund çdo vendim të prokurorisë dhe gjykatës, por realist e ka humbur sensin. Kur kjo ndodh me mua, po me njerëzit që nuk kanë mundësi", tha Tahiri.

syeshëm", deklaroi Tahiri. Seanca e mbajtur ditën e djeshme ka qenë me dyer të mbyllura. Megjithatë, "Gazeta Shqiptare" ka mundur të mësojë përplasjen që ish-ministri ka pasur me prokurorët

e çështjes së tij. "Kam mesazhet këtu që ju keni trafikuar lajme mbi çështjen time. Megjithatë, do t'ia lëmë gjykatës", mësohet të ketë thënë ish-ministri i Brendshëm. Tahiri ankimoj zg-

jatjen e hetimeve ndaj tij edhe me 3 muaj të tjerë, ndërkohë që në gjykatë u paraqit i shoqëruar nga avokati mbrojtës, Maks Haxhia. Në daljen e tij, ai u shpreh se drejtësia e voutar nuk është më drejtësi. "Në qoftë se kjo ndodh me mua, imagino me njerëzit që kanë 1 mijë halle dhe nuk gjejnë të drejtën. Nëse kjo ndodh me mua, po me ata njerëz që përplasen në dyer e gjykatave? Nuk mbahem peng nga askush, kam respektuar drejtësinë, pavarësisht se është sakrificë nga ana ime. I kam respektuar sepse besoj se çdo vendim, edhe si pasojë



Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri

e deklaratave të mia, është vendim jo i drejtë. Kam heshitur në respekt e pastaj do flas", theksoi ish-ministri. Ai deklaroi se kjo çështje ka kaluar çdo limit të arsyeshëm. "Nuk kishte asnjë sekret, më besoni. Ju keni aq shumë mesazhe në telefonat tuaj nga prokurorët, sa nuk ka më sekret. Unë sigurisht i kam dhe mund t'i bëj publike. Gjykata kërkoi dokumentet që prokurorët nuk i kishin dhe u shty për të

hënën. Unë akuzohem për trafik ndërkombëtar drogë dhe grup i strukturuar kriminal dhe ndërkohë në Itali prokuroria antimalafa dhe gjykata ka thënë që nuk ka lidhje ky njeri. Kurse këtu vazhdon e zgjatet, sepse kam frikë se nuk dinë si ta mbyllin. Prokuroria reagoi për nxjerrje hetimi javët e fundit, ishalla nuk je vënë ti nën hetim, por pres dhe në rastin tim të bëjë të njëjtën gjë", tha Tahiri.

Hetimet për skandalin, gjykata vendos "Detyrim paraqitje" për 8 zyrtarë të tjerë


Abuzimi me tenderat, arrestohen 4 zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë

Shkeljet në 5 tendera i shkaktuan shtetit miliona euro dëm, në arrest shtëpie ish-sekretarja e këtij institucioni

Klodiana Lala

TIRANË

Hetimet më shumë se njëvjeçare të Prokurorisë së Tiranës shkaktuan një furtunë të vërtetë në Ministrinë e Drejtësisë. Katër zyrtarë dhe ish-zyrtarë të lartë të këtij institucioni u vunë nën arrest, pas dyshimeve për shpërdorim detyre dhe shkelje barazie në pesë tendera të zhvilluara përgjatë viteve 2016-2017. Në arrest shtëpie është dërguar ish-sekretarja e përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, Juliana Hoxha. Ndërkohë janë dërguar në qeli, drejtori i Shërbimeve Mbështetëse, Aurel Lamçe si dhe specialistët e IT, Lysien Ali dhe Arlind Alikaj. Për 8 zyrtarë të tjerë, gjykata me kërkesën e prokurorisë caktoi masën e detyrimit për paraqitje. Burime zyrtare të institucionit thanë se edhe 14 zyrtarë të tjerë janë nën hetim. Bëhet fjalë për 5 tendera, që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen elektronike të 7 gjykatave administrative, atë të mbikëqyrjes elektronike të të dënuarve, mirëmbajtjen e Regjistrat Noterial Shqiptar, sistemin e monitorimit me kamera për burgun e Lezhës dhe Fushë-Krujës si dhe mirëmbajtjen e sistemit elektronik të çështjeve të përbarimit. Shkeljet janë evidentuar fillimisht nga grupi i inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë e më pas dhe nga grupi i inspektimit të Ministrisë së Financave. Hetimet kanë zbuluar faktin se përmes shpërdorimit të detyrës, zyrtarët i kanë shkaktuar shtetit një dëm të madh financiar. Në fokusin e prokurorisë ishin funksionarët publikë që kanë qenë pjesë e njësive të prokurimit, komisioneve të vlerësimit të ofertave dhe komisioneve për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave.



Juliana Hoxha

Prokuroria e Tiranës

TENDERAT E HETUAR

1. Mirëmbajtja dhe mbikëqyrja e sistemit ICMIS në 7 Gjykatat Administrative.
2. Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale.
3. Përmirësimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e Regjistrat Noterial Shqiptar.
4. Sistemi i monitorimit me kamera për burgun e Lezhës dhe Fushë-Krujës.
5. Përmirësimi dhe mirëmbajtja e sistemit elektronik të çështjeve të përbarimit.

Tenderat janë zhvilluar në kohën kur Ministrinë e Drejtësisë e drejtuan Petrit Vasili dhe Ylli Manjani. Prokuroria deklaroi se nëse e sheh të nevojshme, do t'i thërrasë në pyetje dy ish-

ministrit. Ylli Manjani është emëruar në postin e ministrit të Drejtësisë në datë 10 nëntor të 2015, duke zëvendësuar Nasip Naçon, të dy përfaqësues të LSI-së tek-

sa ka ndenjur në këtë post deri në 30 janar të 2017-ës. Në këtë post Ylli Manjani është zëvendësuar nga Petrit Vasili, gjithashtu përfaqësues i LSI-së që ka qëndruar në krye të Ministrisë së Drejtësisë deri në maj të

2017, kur u zëvendësua nga ministri teknik i Drejtësisë Gazmend Bardhi. Ndërkohë, zbatimet e kontratave kanë vijuar edhe në kohën që dikasterin e drejton Etilda Gjonaj.

ZYRTARËT E AKUZUAR

ARREST ME BURG

1. Aurel Lamçe, drejtori i Shërbimeve Mbështetëse.
2. Lysien Ali, specialist IT.
3. Arlind Alikaj, specialist IT.

ARREST SHTËPIE

1. Juliana Hoxha, ish-sekretare e përgjithshme e MD-së.

DETYRIM PARAQITJE

1. Marsuela Aliaj
2. Dorald Muka
3. Eris Sheshi
4. Ethem Vigani
5. Ornela Bleda
6. Ilir Çuni
7. Arlind Arapi
8. Orgesa Goga

"Gruaja e hekurt", prokurorja kroate takon kreun e KLP

TIRANË - Kreu i KLP, Gent Ibrahim, ka pritur dje në një takim prokurorin special të USKOK, Tamar Laptosh, e cilësuar si një ndër më të mirat. Prokurorja e USKOK pritet të japë eksperiencën e saj në institucionet e reja të drejtësisë. Kreu i KLP-së tha se drejtësia në vende të tjera si Kroacia është pikë referimi. Ai shpreh se SPAK duhet të ngrihet sipas standardeve ndërkombëtare. Nga ana e saj, prokurorja Laptosh theksoi se SPAK duhet të jetë themeli i paanshmërisë e integritetit. Laptosh, prokurorja që hetoi dhe dërgoi në bankën e të akuzuarve ish-kryeministrin kroat, Ivo Sader dhe ish-zkryeministrin do të qëndrojë dy vjet në Shqipëri. Ajo do të japë eksperiencën e saj se si hetohet korrupsioni dhe si hetohen zyrtarët më të lartë. Gjatë një takimi me dyer të mbyllura, Laptosh tregoi se për të hetuar korrupsionin duhet së pari që të përzgjedhurit e SPAK-ut të kenë besueshmëri të lartë, të ketë koordinim mes Gjykatës kundër Korrupsionit dhe SPAK-ut si edhe të ketë vullnet. Deri më tani kanë aplikuar vetëm 12 prokurorë për në SPAK, ndërsa Prokuroria e Posaçme duhet të ketë 15 prokurorë.

"Dy vjet më parë Teodor Lera i çau kokën Evës, ajo e fali për hatër të fëmijëve"

Burri mbyt gruan me duar në fyt dhe tenton vetëvrasjen duke prerë damarët me thikë

57-vjeçari rëndë në spital, fqinjët: Ishte xheloz, nuk e linte të shoqen as të krihte flokët

VLORE

Krimi brenda familjes tronditi Vlorën. Një 57-vjeçar ka mbytur bashkëshorten me duar në fyt dhe më pas ka tentuar të vetëvritet, duke prerë damarët me thikë. Viktima është Eva Lera, nënë e tre fëmijëve, ndërsa autori i krimit është Teodor Lera, i cili aktualisht ndodhet në spital në gjendje të rëndë. Mësohet se kanë qenë fqinjët e çiftit Lera që kanë dëgjuar zhurma dhe më pas kanë sinjalizuar policinë. Pas sinjalizimit të marrë, efektivet blu kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet. Nga kryerja e veprimeve hetimore paraprake, por edhe nga dëshmitë e dhëna nga fqinjët, çifti kishte shpeshherë konflikte, ndërsa burri nuk punonte dhe ishte xheloz për të shoqen, e cila siguronte të ardhurat për familjen. Afro dy vjet më parë, 57-vjeçari Teodor Lera është procedurë penalisht për dhunë në familje.

VRASJA

Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Vlorës dje bënë me dije se ngjarja e rëndë ndodhi rreth orës 12:10 të ditës së djeshme. "Sot rreth orës 12:10, në lagjen 'Kushtrimi', në katin e parë të një pallati është gjetur e pa jetë një shtetase 45 vjeçe. Nga hetimet paraprake dyshohet se ajo mund të jetë vrarë nga bashkëshorti. 57-vjeçari më pas, dyshohet se ka prerë damarët. Ai po merr ndihmë mjekësore në Spitalin Rajonal Vlorë. Grupi hetimor vijon punën për sqarimin e rrethanave të ngjarjes", thuhet në njoftimin e policisë. Dyshohet që bashkëshortët Lera fillimisht kanë debatuar me njëri-tjetrin dhe më pas shërri ka degjeneruar në dhunë. Sipas hetuesve të çështjes, në momentin që ka ndodhur krimi nuk ka pasur person tjetër në banesë, pasi tre fëmijët e çiftit nuk jetonin në Vlorë. Mësohet se njëra prej vajzave jeton në Amerikë, djali në Angli dhe vajza tjetër në Tiranë, ku është studente. Pas mbytjes së gruas së tij 45-vjeçare, Teodor Lera. Në gjendje të rënduar psikologjike ka marrë thikën dhe ka prerë damarët duke tentuar që t'i jepte fund jetës së tij. Ai është transportuar me urgjencë nga policia në spitalin e qytetit bregdetar, ku dhe i është dhënë ndihma e parë mjekësore.

BANORËT

Mbytja me duar në fyt e nënës së tre fëmijëve ka shokuar banorët e qytetit të Vlorës dhe jo vetëm. Banorët të lagjes, fqinjë të familjes



Vendi ku ndodhi vrasja



Fqinja e viktimit duke folur për "GSH"

Lera pohuan dje për "GSH" se Teodor Lera, të cilit të gjithë i thërrisnin Todi, ishte shumë xheloz për gruan e tij, Eva. Ata thanë se ishin në dijeni për xhelozinë e 57-vjeçarit, pasi gruaja nuk dilte nga shtëpia. "Vajza e vogël e çiftit ka ardhur në mëngjes në Vlorë, pasi ajo rrinte në Tiranë, është studente. Todi ishte shumë xheloz dhe e keqtrajtonte Evën. Ai nuk punonte, vetëm gruaja e tij punonte, shiste rroba. Ata jetojnë prej 5 vitesh në shtëpinë e vëllait të tij në Vlorë. Por ishte shumë xheloz. Ajo nuk dilte nga shtëpia, as flokët nuk i krihte, vetëm i shoqi ishte xheloz. Vetëm në punë e brenda. Kanë ardhur nga Bunavia që të punonte edhe ai. Se shtëpinë e tyre e kishin në Bunavi", tregoi fqinja e familjes. Po sipas banorëve, rreth dy vite më parë, çifti Lera procedoi në polici, pasi Teodori

i kishte çarë kokën gruas së tij dhe ishte arrestuar nga forcat e policisë. Por, më pas bashkëshortja e tij, Eva, e kishte falur dhe ishte ribashkuar me babain e fëmijëve të saj. Faktin që Teodor Lera

Krimi në familje, 6 viktima në 2019-ën

Krimi brenda familjes ka marrë përmasa alarmante. Që nga fillimi i këtij viti janë regjistruar 5 viktima. Më 2 janar, një vrasje dyfishë tronditi Ballshin. 34-vjeçari Gazment Musta masakroi me 28 goditje me thikë bashkëshorten 31-vjeçare, Gentiana Çauhajin dhe kунatën 18-vjeçe, Merisa Çauhaj. Krimi makabër ndodhi në sy të 2 fëmijëve të mitur të çiftit. Konflikti nisi pasi 34-vjeçari refuzoi kërkesën e gruas së tij për të shkuar të prindërit e saj me rastin e Vitit të Ri. Ndërsa, më 14 janar në Tiranë, dhëndri vrau vjehrrën dhe vjehrrin dhe më pas i dha fund jetës së tij. Bëhet fjalë për Bujar Matën me origjinë nga Burreli, i cili qëlloi për vdekje me armë zjarri 63-vjeçarin Bujar Mata dhe bashkëshorten 52-vjeçare të këtij të fundi, Valentina Mata, me origjinë nga Pogradeci. Ndërkaq, ditën e djeshme në Vlorë burri mbyti bashkëshorten 45 vjeçe.

ishte person me precedentë penalë e ka konfirmuar edhe babai i viktimit. Ky i fundit ka mbërritur në banesën ku ndodhi ngjarja, pasi mori vesh për vrasjen e së bijës. I moshuari është shprehur dje

për "Ora News" se ndaj vajzës së tij saj ishte ushtruar dhunë edhe më parë. Ai nuk u shpreh për shkaqet apo arsyen në konfliktin me çiftin Lera, por pohoi se ai e ka qëlluar edhe më parë.

Tentoi të vrasë policët, bie në pranga 69-vjeçari

KORÇË - Një person në gjendje të dehur ka qëlluar ditën e djeshme drejt policisë, por gjithçka ka përfunduar pa të lënduar. Ngjarja e rëndë është shënuar në Korçë, ku G.Xh. është konfliktuar me një 47-vjeçar dhe pas ndërhyrjes së bluve, 69-vjeçari i armatosur ka qëlluar mbi ta. I arrestuari rezultoi i dënuar për veprat penale "Vjedhja" dhe "Dhuna në familje". Pas sinjalizimit për sherrin, shërbimet e policisë janë nisur drejt adresës së dhënë, ku nga verifikimet ka rezultuar se shtetasi G.Xh., në gjendje të dehur, ishte konfliktuar për motive të dobëta me shtetasin A.H., 47 vjeç, duke u bërë shqetësues për banorët, ku shtetasi G.Xh. ishte larguar menjëherë për në banesë ku dyshohet se do merrte një armë zjarri. Në momentin që shërbimet e Komisarariatit Korçë janë drejtuar për tek banesa e tij, 69-vjeçari u ka drejtuar armën e zjarrit automatik, duke tentuar të qëllonte në drejtim të punonjësve të policisë, por fatmirësisht arma u bllokua duke mos realizuar qitjen. Policia ka neutralizuar autorin, duke bërë arrestimin e tij në flagrancë për veprat penale "Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit, mbetur në tentativë" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve dhe i municionit". Materialet në ngarkim të tij do i kalojnë për hetime të mëtejshme Prokurorisë së Korçës.



Pesë muaj në detyrë, shkarkohet drejtori i përgjithshëm i Burgjeve, Stefan Cipa

TIRANË - Drejtori i përgjithshëm i Burgjeve, Stefan Cipa është shkarkuar nga detyra. Ai qëndroi 5 muaj në këtë detyrë, pasi zëvendësoi Arben Çukon, i cili u arrestua më pas në kuadër të operacionit "Vol-v04". Ka qenë vetë Cipa që e ka konfirmuar lajmin, duke pranuar se është transferuar për një tjetër detyrë. Kujtojmë se disa dretues janë ndërruar që nga

2013 te Burgjet, duke nisur me Artur Zoton, Arjan Hoxhën, Arben Çukon deri dje me Stefan Cipën. Cipa vinte nga detyra e zëvendësimit të Brendshëm. Në zgjedhjet e vitit 1997, Cipa u zgjodh deputet i Kuvendit të Shqipërisë për herë të parë e më pas edhe në 2 legjislatura të tjera. Gjatë legjislaturës 1997-2002 ka mbajtur funksionin e zv.kryetarit të Komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare. Në muajin shkurt 2002, emërohet ministër i Rendit Publik, detyrë që e ushtroi deri në muajin gusht 2002. Në zgjedhjet lokale të vitit 2011, z. Cipa u zgjodh kryetar i Bashkisë së Sarandës, për një mandat 4-vjeçar. Në datë 13 janar 2016 u emërua nga Këshilli i Ministrave, zëvendësimistër i Punëve të Brendshme.

Vendimi i stafit akademik të FSHS/ Peticion për shfuqizimin e ligjit të Arsimit të Lartë

Pedagogët i japin fund grevës, të hënën nis mësimi te Filologjiku e Shkencat Sociale

Dekani Sabri Laçi: Mbështesim kërkesat e studentëve

Voltiza Duro

Javën që vjen, studentët e Filologjikut dhe ata të Shkencave Sociale do t'i rikthehen mësimi, por pa hequr dorë nga format e protestës deri në plotësimin e kërkesave të parashtruara qeverisë dhe ministrisë së Arsimit. Fakulteti i shkencave Sociale, nëpërmjet një vendimi konfirmim se kanë nisur një peticion të përbashkët nga studentë, pedagogë e qytetarë drejtuar qeverisë për shfuqizimin e ligjit për arsimin e lartë. Ditën e djeshme, është zhvilluar mbledhja e jashtëzakonshme ku mori pjesë stafi akademik i Histori-Filologjisë. Pas mbledhjes, dekani i këtij fakulteti, Sabri Laçi tha se gjithë kjo javë do të jetë protestë deri sa qeveria të japë zgjidhje. "Duke pasur parasysh zhvillimet në institucionet e tjera u zhvillua një diskutim gjerësisht. Mund t'ju përmend disa prej vendimeve edhe pse pritet të zbardhet deklarata e plotë. Në këtë javë u vendos të shpallet javë protestë dhe javën në vijim protesta të vazhdojë një ditë me kalendër. Si dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për Arsimin e Lartë.

SABRI LAÇI
Gjithë kjo javë do të jetë protestë deri sa qeveria të japë zgjidhje. "Duke pasur parasysh zhvillimet në institucionet e tjera u zhvillua një diskutim gjerësisht. Mund t'ju përmend disa prej vendimeve edhe pse pritet të zbardhet deklarata e plotë. Në këtë javë u vendos të shpallet javë protestë dhe javën në vijim protesta të vazhdojë një ditë me kalendër. Si dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për Arsimin e Lartë.



Nr.184, Nr 185 të datës 26 dhjetor 2018, të cilat bien në kundërshtim me autonominë universitare dhe liritë akademike", thuhet në deklarata. Në këtë të fundit shihet se duhet të krijohen

grupe pune për vazhdimësinë e reagimit në FHF, koordinimin me asambletë e fakulteteve të UT-së dh atyre të IAL-ve të tjera publike, me institucionet shtetërore dhe ndërkombëtare, me

synim ndërgjegjësimin e opinionit për të drejtat e studentëve dhe të stafeve akademike, si dhe për detyrimet që ka qeveria shqiptare për respektimin e tyre, përmes miratimit të akteve ligjore dhe nënlig-

jore të konsultuara paraprakisht me IAL-të publike dhe aktorët e tjerë, si dhe duke siguruar mbështetjen financiare të nevojshme. "Të organizojmë debate mbi problemet e krijuar në IAL-të publike në Sh-

qipëri, të cilat do t'u bëhen të ditura gjithë aktorëve të interesuar për zgjidhjen e tyre, me qëllim garantimin e arsimit publik cilësor në Republikën e Shqipërisë", thuhet më tej në deklarata.

"Po shikojmë rrugë të tjera presioni ndaj qeverisë"

Jani Marka: Përplasjet mes pedagogëve, një pjesë e tyre të nënshtruar nga politika

Mesur pedagogëve ka pa vazhdimin e protestës, kjo pasi një pjesë e tyre i janë nënshtruar politikës dhe burokracisë universitare. Kjo deklarata është bërë nga pedagogu i Shkencave të Natyrës pranë UT-së, Jani Marka në një intervistë për Gazeta Shqiptare. Ai thekson se nuk mund të ketë përmirësim të arsimit të lartë pa hartimin e një ligji të ri, me përfshirjen e pedagogëve dhe studentëve, në një proces të gjatë, transparent e demokratik. Marka bën me dije se duhen gjetur rrugë të tjera të presionit, si nënshkrimi i peticioneve nga studentët e pedagogë, e deri te protesta disa orëshe të mirëorganizuar në ditë të caktuara, kjo me synim përbushjen e kërkesave dhe rrëzimin e ligjit për arsimin e lartë.

VENDIMET E FILOLOGJIKUT

Pas mbledhjes së jashtëzakonshme nga në Fakultetin e Histori-Filologjisë janë zbardhur edhe vendimet që u morën dje nga asambleja e stafit akademik. "Pas konstatimit se situata mbetet shqetësuese që prej dhjetorit 2018, pedagogët e vendosën: Të rikonfirmojnë mbështetjen për kërkesat e drejta të studentëve dhe të garantuar mirëorganizuar në ditë të caktuara, kjo me synim përbushjen e detyrimeve të programeve mësimore; të shpallin protestë në mjedisin e fakultetit deri në fund të kësaj jave dhe, nëse do jetë e nevojshme edhe në vijim, një ditë në javë, deri në plotësimin nga ana e qeverisë të Ligjit për Arsimin e Lartë, shfuqizimin e VKM-ve. Nr.777, Nr.781, Nr.781, Nr.783, si dhe të urdhrave Nr.183,

Pse vendosën pedagogët të hyjnë në grevë dhe deri sa do të vazhdojë bojkoti nga ana juaj?
Unë jam pedagog te Shkencat e Natyrës, megjithatë jam në dijeni se hyrja në grevë ishte si reagim i



kolegëve të FSHS në mbështetje dhe solidaritet me studentët, si dhe ndaj mungesës së reagimit të MASR për kërkesat e paraqitura nga Takimi i Asambleve të Fakulteteve të UT. Më tej, Asambleja e Personalit Akademik të FSHS ka vendosur të përfundojë sot (dje) grevën triditore, për t'i lënë rrugën formave të reja të organizimit, deri në shfuqizimin e ligjit "Për Arsimin e Lartë", por edhe drejt procesit të reformimit të brendshëm të universiteteve.

A ka pasur përplasje mes pedagogëve lidhur me protestën dhe pezullimin

e mësimi?
Natyrisht që ka pasur përplasje mes pedagogëve, pasi një pjesë e pedagogëve janë vënë në shërbim të interesave të pushtetit politik, apo nënshtruar prej politikës dhe burokracisë universitare, përkundër interesit të universitetit dhe studentëve.

A i janë bashkuar grevës edhe pedagogë nga fakultete të tjera?

Greva është një akt kolektiv, i shpallur nga asambletë e trupave akademike, dhe në këtë kuptim në mënyrë të qartë për grevë ishin shprehur vetëm pedagogët e FSHS.

JANI MARKA

Unë jam pedagog te Shkencat e Natyrës, megjithatë jam në dijeni se hyrja në grevë ishte si reagim i kolegëve të FSHS në mbështetje dhe solidaritet me studentët, si dhe ndaj mungesës së reagimit të MASR për kërkesat e paraqitura nga Takimi i Asambleve të Fakulteteve të UT.

Nëse nuk do të plotësohen kërkesat, cilat do të jenë hapat e mëtejshëm?

Falë protestës madhështore të studentëve, nisur në dhjetor, ka nisur një cikël historik i transformimit të universiteteve publike në Shqipëri. Këtë cikël nuk do të mund ta ndalë askush, por në anën tjetër duhet të jemi edhe të duruar e të matur në

zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme. Pas gati dy muajsh bojkot, dhe kundër presionit të qeverisë për dëgjim e vitit akademik, tashmë mendoj se duhen gjetur rrugë të tjera të presionit, si nënshkrimi i peticioneve nga studentët e pedagogë, e deri te protesta disa orëshe të mirëorganizuar në ditë të caktuara.

Cili është reagimi juaj ndaj deklaratave të ministres Besa Shahini, e cila thekson se është për përmirësimin e arsimit të lartë, por kundër ndryshimit të VKM-ve?

Nuk mund të ketë përmirësim të arsimit të lartë pa hartimin e një ligji të ri, me përfshirjen e pedagogëve dhe studentëve, në një proces të gjatë, transparent e demokratik. Nuk mund të ketë, gjithashtu, përmirësim nëse shteti nuk rrit buxhetin për arsimin në tërësi, dhe atë të lartë në veçanti, dhe ta kthejë arsimin si prioritet kombëtar. Në këtë kuptim, VKM-të janë një element i vogël e i parëndësishëm në panoramën e përgjithshme.

ABUZIMI SEKSUAL STATISTIKAT

Drejtori i ALO 116: Përdhunimi i 13 vjeçares, hetim i thellë nga prokuroria

Shifrat, 220 raste të ngacmimit dhe abuzimit seksual në Shqipëri

Mirgjit Vataj: Fenomeni, i pranishëm edhe në shkolla

Voltiza Duro

Brenda 10 vitesh, pranë ALO 116 janë raportuar 220 raste të ngacmimit, abuzimit dhe dhunës seksuale, madje edhe në shkollë kryesisht nga vajzat e moshës 13-15 vjeç. Ndërkohë, 6 raste janë konstatuar në 2017-ën, dhe po 6 vajza në 2018-ën, kanë denoncuar se kanë rënë pre e abuzimit, ndër të 1 rast në shkollë. Këto statistika janë bërë publike gjatë intervistës për 'Gazeta Shqiptare', nga drejtori i Linjës Kombëtare të Keshillimit për Fëmijë, ALO 116, Mirgjit Vataj. Ky i fundit, nisur nga ngjarja e rëndë e përdhunimit të një 13 vjeçare në Kavajë, thekson se përgjegjësi për abuzime të tilla është i gjithë sistemi duke filluar nga drejtoria e shkollës, stafi akademik dhe psikosocial, keqpërdorimi i teknologjisë dhe vetë edukimi që fëmijët e adoleshentët marrin në familje. Vataj sugjeron që prokuroria duhet të hetojë në mënyrë të thellë dhe të detajuar të gjithë aktorët lokalë për të kuptuar se çfarë ka ndodhur dhe kushdo që ka patur dijeni dhe nuk e ka raportuar në kohë të përballit me përgjegjësinë. Drejtori i ALO 116 thekson më tej se problem tjetër i madh është edhe ofrimi i shërbimeve për viktimat e abuzimit seksual. Sipas tij jo të gjitha zonat e Shqipërisë janë të mbuluara me shërbime sociale dhe aq më tepër me suport psikologjik për viktimat.



Drejtori i Linjës Kombëtare të Keshillimit për Fëmijë, ALO 116, Mirgjit Vataj



Foto ilustruese

220

RASTE, ABUZIM SEKSUAL

Gjatë këtyre 10 viteve pranë ALO 116 janë raportuar 220 raste të ngacmimit, abuzimit dhe dhunës seksuale, madje edhe në shkolla kryesisht nga vajzat e moshës 13-15 vjeç. Ndërkohë, abuzimi seksual është raportuar në 6 raste në 2017 dhe 6 raste në 2018, 1 rast abuzim/ngacmim seksual në shkollë dhe 4 të tjera abuzim/ngacmim seksual në komunitet.

Disa ditë më parë opinioni publik në vend është tronditur pas ngjarjes së përdhunimit të një 13 vjeçareje nga 8 bashkëmoshatarë të saj. Mendoni se strukturat lokale kanë pasur dijeni lidhur me këtë abuzim të rëndë?

Duke u nisur nga eksperiencia ime personale prej 10 vitesh në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe nga përmasat e ngjarjes nuk besoj se strukturat lokale nuk kanë patur dijeni. Nëse ka gjasa që strukturat lokale nuk kanë patur dijeni atëherë vihet në dyshim profesionalizmi dhe puna e strukturave lokale atje. Si ka mundësi që një vajzë abuzohet prej kaq kohësh ku dhunuesit janë shumë më shumë se një dhe askush nuk ka informacion????? Singjerisht nuk më bën sens dhe nuk më duket bindës fakti që askush nuk ka patur dijeni.

Sipas jush, kush janë përgjegjësit kryesorë të ngjarjes?

Përgjegjës për rastin në fjalë është i gjithë sistemi duke filluar që nga drejtoria e shkollës, stafi akademik dhe psikosocial. Misioni kryesor i stafëve akademikë të shkollës është që të rrisë kapacitetet e nxënësve, por në të njëjtën kohë edhe të monitorojë sjelljen e secilit nxënës që frekuenton shkollën. Bashkë me stafin e shërbimit psikosocial duhet të bëhen monitorime për të marrë të gjitha masat që fëmijëve tu garantohet një ambient i sigurt në shkollë.

Sa e sigurt është shkolla në Shqipëri?

Unë mendoj se shkolla ka treguar mangësi në krijimin e një mjedisi të sigurtë pavarësisht faktit që abuzimi nuk ka ndodhur

5%

TË DHUNUAR SEKSUALISHT

Ka një studim të vitit 2013 që tregonte se 11% e fëmijëve që kishin marrë pjesë në studim tregonin që kishin provuar të paktën një herë një ngacmim seksual, ndërsa 5% tregonin që kishin provuar dhunë seksuale.

brenda ambienteve të shkollës, por që shumica e nxënësve të përfshirë në këtë abuzim janë të së njëjtës shkollë të paktën nga informacionet paraprake. Gjithashtu, edhe strukturat lokale të shërbimit social duke filluar që nga bashkia kanë mangësi. Por mendoj se edhe familjet kanë pjesën e tyre të përgjegjësisë. Si i edukojmë në fëmijët të sillen me vajzat. Çdo prind ka detyrimin të mirërrisë fëmijën bazuar në vlerat dhe parimet më të larta të respektit ndaj grave dhe vajzave.

Sipas mendimit tuaj, cilat janë masat që duhet të merren ndaj fajtorëve?

Besoj se në këtë rast është prokuroria që duhet të hetojë në mënyrë të thellë dhe të detajuar të gjithë aktorët lokalë për të kuptuar se çfarë ka ndodhur dhe kushdo që ka patur dijeni dhe nuk e ka raportuar në kohë të përballit me përgjegjësinë e mosraportimit të rastit.

Sa ka ndikuar keqpërdorimi i teknologjisë dhe edukimi në familje në gjithë këtë ngjarje?

Sigurisht që edhe teknologjia ka efektin e vet në ditët e sotme. Fëmijët dhe adoleshentët duke qenë të ekspozuar ndaj një vrullit informacioni, shpesh edhe të pafiltruar dhe duke u frymëzuar nga shembuj jo

të mirë të promovuar nga media sociale kryesisht ndikohen. Kjo duhet të jetë dhe një alarm për prindërit që minimumim duhet të njihen me aktivitetin që fëmijët e tyre bëjnë online, shembuj që ata ndjekin dhe të kalojnë kohë cilësore duke biseduar me fëmijët e tyre. Neglizhenca dhe efekti i shembujve negativë do bëjnë efektin e tyre në personalitetin dhe sjelljet e fëmijëve dhe të adoleshentëve.

Sa raportime kanë mbërritur në

TRAJTIMET

Problem tjetër i madh është edhe ofrimi i shërbimeve për viktimat e abuzimit seksual. Fatkeqësisht jo të gjitha zonat e Shqipërisë janë të mbuluara me shërbime sociale dhe aq më tepër me suport psikologjik. Në ato rate kur ka qenë e mundur në bashkëpunim me organizata partnere kemi ofruar mbështetjen psikologjike për viktimat

ALO 116 lidhur me ngacmim apo abuzim seksual ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve brenda harkut kohor 10 vjeçar që operon ky mekanizëm në vendin tonë?

Gjatë këtyre 10 viteve pranë ALO 116 janë raportuar 220 raste

të ngacmimit, abuzimit dhe dhunës seksuale, madje edhe në shkolla kryesisht nga vajzat e moshës 13-15 vjeç. Ndërkohë, abuzimi seksual është raportuar në 6 raste në 2017 dhe 6 raste të abuzimit seksual në 2018, 1 rast abuzim/ngacmim seksual në shkollë dhe 4 të tjera abuzim/ngacmim seksual në komunitet. Në të gjitha rastet kanë qenë vajzat ato që kanë kontaktuar ALO 116 për të raportuar abuzimin seksual. Për sa i përket trendit të ngacmimit seksual këtë nuk mund ta themi sepse nuk ka statistika të veçuara për krimet seksuale ndaj fëmijëve nga policia, prokuroria apo gjykata. Ka një studim të vitit 2013 që tregonte se 11% e fëmijëve që kishin marrë pjesë në studim tregonin që kishin provuar të paktën një herë një ngacmim seksual, ndër-

sa 5% tregonin që kishin provuar dhunë seksuale.

Nga cilat qytete kanë ardhur më së shumti denoncimet dhe si kemi proceduar me rastet? A janë denoncuar dhe ndëshkuar fajtorët?

Më së shumti rastet janë raportuar nga zonat e mëdha urbane në Shqipëri. Për të gjitha rastet kur kemi patur të dhëna të sakta dhe të verifikuara janë raportuar pranë Policisë së Shtetit, e cila në çdo moment që ne kemi referuar raste ka reaguar duke nisur procedime dhe për secilin rast të verifikuar, çështjet janë dërguar në prokurori. Në shumicën e rasteve bazuar në faktet dhe të dhënat abuzuesit janë dënuar.

Po fëmijët si trajtohen pas këtyre denoncimeve, a ndiqen në terapi me psikologë? Ku qëndron ngërçi sipas jush, në kornizën ligjore apo në sistemin zinxhir të mekanizmave të mbrojtjes?

Problem tjetër i madh është edhe ofrimi i shërbimeve për viktimat e abuzimit seksual. Fatkeqësisht jo të gjitha zonat e Shqipërisë janë të mbuluara me shërbime sociale dhe aq më tepër me suport psikologjik. Në ato rate kur ka qenë e mundur në bashkëpunim me organizata partnere kemi ofruar mbështetjen psikologjike për viktimat, por fatkeqësisht në shumicën e rasteve viktimat mbeten pa shërbime mbështetëse. Një çështje e abuzimit seksual ndaj fëmijëve nuk zgjidhet duke u arrestuar vetëm agresori, por duhen shërbime mbështetëse dhe afatgjata edhe për viktimat.

Table with multiple columns containing names, professions, and numerical data. Includes sub-sections like 'QARKU FIER MAMI', 'QARKU KUKËS', and 'QARKU GIROKASTËR'. Columns include names, professions, and numerical values.

Rrëfhet këngëtarja: Nga "X-Factor" ruaj kujtime të bukura

Enxhi Nasufi:

Kënga ime thirrje për ritëm, rivalitetin e kam me veten

"Çdo përjetim në skenë është i veçantë"

Egla Xhemali

Të gjithë e mbajnë mend si konkurrenten më të fortë që ka pasur "X-Factor Albania" deri më sot. Që në daljet e para të saj ka rënë në sy mënyra se si ajo e zotëronte skenën e se si përcillte emocione e siguri përmes performancës. E kemi fjalën për Enxhi Nasufin. Pas vlerësimit që mori asokohe nga juria dhe publiku i spektaklit, bukuroshja vazhdoi rrugëtimin e saj drejt muzikës duke sjellë kështu disa këngë shoqëruar me klippe, të cilat kanë rezultuar të suksesshme. Enxhi posedon një energji të jashtëzakonshme që elektrizon skenën. Duket sikur ka lindur për të qenë 'Div'. Për të, të gjitha përjetimet që kanë lidhje me muzikën, janë të çmuara. Nasufi ndan për "Gazeta shqiptare" kujtimet nga "X-Factor", pasionin e madh për muzikën, copëza nga takimet me njerëzit dhe çfarë i impresionon ata kur e takojnë për herë të parë, si dhe dashurinë me të cilën është rritur nga familja. Nasufi sapo ka publikuar këngën "Ti", e cila është pritë mjaft mirë nga publiku. Ajo thotë se kënga u kushtohet të gjithëve. Përtej shkëlqimit në ekran, Enxhi ngelet një vajzë e thjeshtë dhe me shpirtin plot ngjyra, tamam artiste.

Si janë çastet pas provave për një koncert?

Momentet e provave janë shumë të rëndësishme, natyrisht pas provave e vetmja gjë që ke në mendje është dita e performancës. Është shumë e rëndësishme që gjatë provave të jesh tepër e qetë, e relaksuar dhe të marrësh maksimumin nga to.

Gjëja e parë që të vjen në mend kur kujton "X-Factor"?

Më vijnë shumë gjëra në mend, shumë kujtime. Jam kënaqur shumë dhe kam fituar shumë prej atij kompeticioni. Këto lloj konkuresh të zhvillojnë jo vetëm nga ana artistike, por



edhe si njeri. Të mësojnë të jesh shumë korrekt dhe të mbash tepër përgjegjësi.

Përjetimi më i çmuar nga skena?

Nuk mund të veçoj një. Nga skena marrë gjithmonë përjetime ndryshe dhe tepër të çmuara.

Sapo ka dalë kënga "Ti". Kujt i dedikohet? Si është pritë nga publiku?

Kënga ime i drejtohet gjithë publikut, të gjithë dëgjuesve, askujt në veçanti. Është një thirrje e bukur për ritëm, ngjyra jete dhe shumë pozitivitet. Deri tani mendoj

që e kanë pritë shumë mirë dhe është pëlqyer goxha. Kjo më jep shumë kënaqësi dhe energji për të bërë akoma më shumë.

Refreni që do e këndoje pa pushim?

"But, there's a hope that's waiting for you in the dark"

You should know you're beautiful

just the way you are

And you don't have to change a thing

The world could change it's heart

No scars to your beautiful we're stars and we're beautiful.

Muzika krijon dhe rivalitete. Sa i ndjen Enxhi ato?

Varet se nga cili këndvështrim i sheh gjërat. Unë nuk i shoh nga ky këndvështrim.

Rivalitetin dua ta kem vetëm me veten dhe dua të punoj shumë me veten për të qenë çdo ditë edhe më mirë dhe për të bërë çdo ditë diçka edhe më të mirë.

Përtej skenës, gjëja e parë që i impresionon njerëzit kur të takojnë?

Me kanë thënë që sinjeriteti dhe thjeshtësia, përfshirë edhe ajo e paraqitjes së jashtme, por edhe komunikimi



mbi të gjitha.

Nga e kupton që ke kaluar një ditë 'uragan'?


Nga sasia tepër e madhe e energjisë. Në fakt s'më pëlqen të kaloj ditë "uragan", më pëlqen të aktivizohem të mërmërem me punët e mia, por energjia e tepërt nuk është aspak e mirë. Ndoshta ka ditë dhe momente që s'i shmangesh dot, por përpiqem t'i kontrolloj.

9) Në retrospektivë si ka qenë fëmijëria jote?

Ka qenë e mbushur plot me gjëra shumë të bukura, por edhe përjetime të forta. Gjithsesi më kanë ndihmuar të jem kjo që jam sot. Gjëja më e bukur është që jam rrethuar nga shumë njerëz që më kanë dhënë shumë dashuri.

Një vend që të bën të prekësh parajsën?

Shtëpia ime absolutisht dhe përqaftimi i njerëzve që dua më shumë në këtë botë (Përfshirë dhe përqaftimi i genushes sime Cookie).



S'e dinim! Mësoni lidhjen e velinës së 'Stop'-it me Yllin Limanin

Ajo është velina më e re e Aprogramit "Stop". Bukuroshja quhet Aulona Limani dhe është as më pak e as më shumë se 19 vjeçe. Aulona është me origjinë nga Kumanova e Maqedonisë dhe është shumë e apasionuar pas baletit, me të cilin ka filluar që merret që prej moshës 3 vjeçare. Gjatë puntatës së emisionit të së martës, gazetari Saimir Kodra ka zbuluar për publikun lidhjen e Aulonës me këngëtarin e njohur shqiptar, Ylli Limani. Në momentin kur shfaqet kënga e Ylli Limanit në sfond, Saimir thotë: Ehh more Ylli çfarë kushërire ke", duke iu referuar Aulonës. Kjo e fundit vazhdoi të kërcente, duke mos e mohuar atë që tha moderatori, por teksa i hodhëm një sy "Instagramit" të tyre, pamë që ata nuk ndjekin njëri-tjetrin.




Pasi i dha fund me iranianin Morena vendos të martohet, detaji që do ju habitë

Ndarja e bujshme e këngëtares shqiptare nga miliardi iranian, Sasha Sobhani u komentua gjerësisht në mediat online. Kur u ndanë, Morena e quajti atë gay, ndërsa Sasha nuk ndaloi së ngacmuari këngëtares shqiptare me postime të ndryshme në rrjetet sociale, madje erdhi edhe në Shqipëri ku u pa në shoqërinë e shumë këngëtareve të famshme. Por, që pas ndarjes, nuk kemi parë ndonjë djalë tjetër në jetën e Morena Tarakut, mirëpo siç duket ajo i paska planët e qarta. Këngëtarja nga Kosova publikoi në "Instastory" një imazh ku shfaqet me një unazë me një diamant gjigand, në gishtin e fejesës. Për të na habitur akoma më shumë, Morena shkruan në mbishkrimin e fotos "Thashë po" të shoqëruar me një emoji, që jep ndjesinë e të qenit e dashuruar.



Ndarje me zhurmë! Lori vazhdon me mesazhe të koduara për Visin

U bënë gati dy javë që përfillet se Lori Hoxha i ka dhënë fund lidhjes 6-vjeçare me bukuroshin Vis Bajraktari. Edhe pse asnjë prej tyre nuk e ka konfirmuar këtë lajm, fakti që nuk e ndjekin më njëri-tjetrin në "Instagram" dhe postimet me "kunja" kanë bërë që të shpërthejnë thashethemet. I fundit ishte postimi i Visit në Snapchat ku publikoi një video me këngën "Creep on me", por Lori ka vijuar me postimet dhe duken shumë kuptimplotë. Ajo ka publikuar dy foto nga Londra ku në njërin thotë "Nuk jam për të gjithë dhe në tjetrën "Mezi jam për vete". Vazhdojnë kodet mes tyre? Ç'ka dashur të thotë Lori këtë herë?



Utakua me yllin botëror, zbuloni çfarë i ngeli ndërmend nga Era Istrefi

Era Istrefi po përgatitet për hitin e radhës. "Selfish" titullohet kënga që do vijë në bashkëpunim me DJ e famshëm Dimitri Vegas dhe Like Mike. Por teksa vazhdon regjistrimin e këngëve të reja, Era Istrefi po qëndron në Amerikë dhe sigurisht nuk mund të mungojnë dhe takimet me yjet botërorë. E një prej tyre që ka takuar është pikërisht miku i tij, DJ i famshëm, Diplo, me të cilin edhe bashkëpunoi për projektin "Live it Up", që ishte himni i Kampionatit Botëror "Rusi 20018". Fillimisht Era pozon me DJ-in duke shkruar: "Shiko kë takova". Por këtë herë ajo që i ka mbetur fiks nga pamja e këngëtares duket se ishin thonjtë e zbukuruar me gurë, ndërsa Diplo përmend se janë bërë në Kosovë.



Maqedonia e Veriut në NATO, Shqipëria nënshkruan e para

Arritje e dytë për shtetin fqinj, Stoltenberg: Moment historik për Zaev dhe Tsipras

Ditën e djeshme, sekretari i Përgjithshëm i NATO dhe ministri i Jashtëm maqedonas kanë nënshkruar protokollin për pranimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Në praninë edhe të 29 ambasadorëve, kryediplomatit maqedonas u ul për herë të parë në tryezë të rrumbullakët të aleancës ushtarake. Stoltenberg mirëpriti Shkupin si anë-

tarin e 30 dhe tha se anëtarësimi i vendit do ta bëjë Ballkanin, por edhe vetë NATO-n më të sigurtë. Nga ky moment, Maqedonia e Veriut do të ketë mundësinë të jetë e ftuar në samitet e aleancës ushtarake. Protokollin i pranimit do të shpërqehet me miratimin në 29 parlamentet e vendeve

anëtare, për njohjen zyrtare. Hapi historik për Shkupin vjen pas arritjes së "Marrëveshjes së Prespës" me Greqinë, për ndryshimin e emrit. Në selinë e NATO-s në Bruksel u zhvillua ceremonia e protokollit, ndërsa Shqipëria ka qenë vendi i parë që ka nënshkruar pro për shtetin fqinj.

Pas nënshkrimit të Protokolli të anëtarësimi të Maqedonisë në Aleancë, Kuvendet e vendeve anëtare duhet ta ratifikojnë protokollin dhe Maqedonia do të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e NATO-s. Ndërkohë gjenerali i NATO-s Jens Stoltenberg deklaroi se ky është një moment historik për vendin



Sekretari i Përgjithshëm i Natos, James Stoltenberg

dhe se kryeministrat Zoran Zaev dhe Aleksis Tsipras kanë treguar guxim të madh me arritjen e Marrëveshjes së Prespës.

Sipas tij, vullneti i treguar nga dy kryeministrat ka rritur sigurinë dhe njëherësh ka forcur stabilitetin në Ballkan.

Presidenti kosovar: Putin na mbështet nëse ka dialog mes palëve

Dialogu me Serbinë, Thaçi: S'ka njohje reciproke pa definim të kufirit

"Askush nuk ka hedhur në tavolinë hartat për ndryshim kufijsh"

Ditën e djeshme, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ishte në një intervistë për 'Zërin e Amerikës' ku foli lidhur me të rejtat e procesit të dialogut me Serbinë. Ndër të tjera Thaçi shprehet se arritja e një marrëveshje me Serbinë për kufirin është më se e rëndësishme që ky shtet ta njohë Kosovën. "Korrigjimi kemi bërë edhe me Maqedoninë edhe me Malin e Zi ka pasur kërcënime e dërgime mesazhesh jo të mira për shtetin tonë, por në fund e kanë kuptuar që marrëveshja ka qenë e drejtë. Prandaj them se është tani koha që ta definojmë punën e kufirit me Serbinë. Nuk ka njohje reciproke pa definimin e kufirit", u shpreh Thaçi. Sipas tij, Kosova duhet të shohë me largpamësi, të mendojë për të ardhmen, e në këtë linjë premtosi se ka marrë siguri nga Serbia për njohjen e Kosovës nëse definohet kufiri mes dy vendeve. "Serbia është e përfshirë në dialog, ka shprehur mundësi për njohjen e Kosovës edhe Rusia ka dërguar mesazh se nëse palët merren vesh ne do t'i mbështesim. Ketë mesazh ma ka dërguar mua personalisht edhe Presidenti Putin", - tha Thaçi. Thaçi foli ndër të tjera për një marrëveshje të hapur që mund të kalojë edhe nëpërmjet një referendumi ndërsa vendimmarrja i mbetet Kuvendit. Gjithashtu, pyetjes nëse ka pika të tjera të kuqe në shtetin kosovar përveç atyre që u diskutuan më parë, Presidenti i Kosovës ka thënë se nuk ka dialog nëse nuk ka siguri për njohje të vendit, gjithashtu, ai theksoi se askush nuk ka hedhur në tavolinë hartat, por marrëveshja do të bëhet mes njohjes nga të dy vendet. "Nuk ka dialog nëse nuk ka siguri për njohje. Askush nuk ka hedhur në tavolinë hartat, por marrëveshja do të bëhet mes njohjes nga të dy vendet", - ka thënë Thaçi. Gjithashtu, ai tha se gjithçka mbetet në dorë të delegacionit kosovar, i cili është përzgjedhur nga parlamenti për të përfaqësuar shtetin në dialogun me Serbinë. "Adresa për dialogun me Serbinë mbetet në dorë të Ahmetit", ka thënë Thaçi. Kurse i pyetur lidhur me takën e vënë ndaj Serbisë, Thaçi është përgjigjur se Kosova ka



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

qenë gjithmonë e disponueshme për dialog dhe se kjo s'ka patur të bëjë asnjëherë me takën të vënë ndaj shtetit fqinjë. "Unë pres maturi. SHBA-ja na mbështeti në themelimin e ushtrisë. Ne kemi insistuar të vazhdojë dialogu pavarësisht vendosjes së takës. Tjetër gjë është dialogu e tjetër gjë është taksa", shprehet presidenti kosovar. Gjithashtu, ai ka thënë se e rëndësishme është edhe marrëdhënia shumë e mirë që Kosova ka me shtetin e SHBA-së, i cili ishte mbështetës në krijimin dhe njohjen e FSK-së. Kështu që sipas presidentit Thaçi kjo nuk e bën Amerikën të jetë kundër Kosovës në këtë moment, por pro dialogut me Serbinë. "Masat e marra ndaj Kosovës janë veprim i duhur, por jo në kohën e përshatshme. Të hapet rruga për vazhdimin e dialogut për komunikimin e Kosovës dhe Serbisë. Por më e rëndësishme

janë raportet e shkëlqyera që kemi me SHBA-në", ka thënë Thaçi. Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi është i bindur se Serbia do të njohë Pavarësinë e Kosovës, vetëm përmes procesit të korrigjimit të kufijve. "Duhet të punojmë për një zgjidhje kreative ku të dy palëve do t'u plotësohen interesat. Nuk ka njohje reciproke pa definimin e kufirit". Në një intervistë për Zërin e Amerikës, Thaçi raportoi se korrigjimi i kufijve nuk cenon resurset shtetërore të Kosovës. "Mendoj që do të ishte shumë e logjishme përfshirja e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit në territorin e Kosovës, duke mos i cenuar në asnjë rrethanë resurset e shtetit të Kosovës, as Gazivodën, as veriun e Mitrovicës, as Trepcën". Kreu i shtetit kosovar nuk ka një përgjigje për mundësinë e shkëmbimit të jugut shqipfolës të Serbisë me veriun serbishtfolës të Kos-

ovës. "Unë nuk mund të përgjigjem në diçka që nuk më është kërkuar". Megjithatë një gjë është e sigurt, sipas Thaçit, që marrëveshja përfundimtare do të arrihet vetëm nëse Serbia pranonte njohje Kosovës si shtet të pavarur, çka garantonte njohjen ndërkombëtare të shtetit më të ri ballkanik. Ndërkaq në pyetjen e fundit gazetari ka kërkuar të dijë lidhur me diskutimin nëse në prapaskanat e dialogut është përmendur ndonjë gjë lidhur me ndryshimin e kufijve të Kosovës. Presidenti Thaçi ka thënë se gjithmonë është diskutuar për njohjen e vendit dhe se diskutime për kufijtë ka patur edhe më parë lidhur me shtetet e tjera fqinje si Maqedonia apo Mali i Zi ku i janë dërguar edhe kërcënime në adresë të krerëve të shtetit, por që në fund është arritur një marrëveshje.

HASHIM THAÇI

"Duhet të punojmë për një zgjidhje kreative ku të dy palëve do t'u plotësohen interesat. Nuk ka njohje reciproke pa definimin e kufirit. Mendoj që do të ishte shumë e logjishme përfshirja e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit në territorin e Kosovës, duke mos i cenuar në asnjë rrethanë resurset e shtetit të Kosovës, as Gazivodën, as veriun e Mitrovicës, as Trepcën," ka thënë Thaçi.

Taksa, sekretari i OKB: Po rriten tensionet mes Serbisë dhe Kosovës

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, është shprehur i shqetësuar për tensionet në rritje në mes Beogradit dhe Prishtinës, veçanërisht në pjesën veriore të Kosovës. Ai u bëri thirrje udhëheqësve të të dyja vendeve që të përmbahen nga veprimet e mëtejshme që mund të përkëqesojnë edhe më tej situatën, shkruan N1. Guterres theksoi se i gjithë ky tension i situatës ndodhi për shkak të vendimit të Prishtinës për të rritur taksen e importit 100% për mallrat nga Serbia dhe Bosnja, vendim ky të cilin deri më tani Prishtina nuk ka pranuar ta pezullojë pavarësisht thirrjeve të përsëritura nga SHBA-të dhe BE-ja. "Tensionet midis Beogradit dhe Prishtinës vazhdojnë të rriten dhe të kenë ndikim negativ në procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve", u shpreh Guterres. Ai kërkoi nga liderët e të dyja vendeve "që të përdorin kokën e ftohtë në kërkim të progresit për dialogun", tha Guterres.

ANTONIO GUTERRES

"Tensionet midis Beogradit dhe Prishtinës vazhdojnë të rriten dhe të kenë ndikim negativ në procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve", u shpreh Guterres. Ai kërkoi nga liderët e të dyja vendeve "që të përdorin kokën e ftohtë në kërkim të progresit për dialogun". Guterres, gjithashtu, rikujtoi se taksa nga Serbia dhe Bosnja është futur pas dështimit të Kosovës për të siguruar anëtarësimin në Interpol. Raporti i ri i OKB-së mbi Kosovën është dorëzuar ambasadorëve të shteteve anëtare të Këshillit të Sigurimit në një kohë kur ende nuk dihet nëse Kosova do të jetë në rendin e ditës së mbajtjes së sesionit të veçantë për Kosovën, për shkak të kundërshtisë që ka ardhur nga vendet perëndimore.

Presidenti i Venezuelës: Kreu i SHBA do pasuritë e Venezuelës

Maduro: S'dua të futem në histori si tradhtar, kërkoj të ndalohej çmenduria e Trump



NIKOLAS MADURO

"Nuk më intereson se si do të hyj në histori, por nuk do të jem një tradhtar, një njeri i dobët, një njeri që u kthen shpinën angazhimeve të tij historike ndaj popullit", - u shpreh Maduro.

toja nga çdo mjet komunikimi për t'i kërkuar gjithë botës që të denoncojë dhe të ndalojë çmendurinë e Donald Trump. Venezuelë kurrë nuk do dorëzohet". Ai shtoi se një ndërgjegjës global do të çonte në një "mohim" të presidentit amerikan. Maduro tha se populli venezuelian është i

përgatitur të mbrojë tokën e tij "të shenjtë" nga një pushtim ushtarak amerikan. Por, theksoi se i lutet Perëndisë se një konflikt i tillë të mos ndodhë kurrë. "Agresioni ushtarak i Trump duhet të hidhet poshtë në mënyrë që të mbizotërojë paqja", - tha Maduro. Presidenti i Venezuelës u shpreh se burimet e mëdha natyrore të vendit e kanë bërë atë objektivi kryesor për ndryshimin e regjimit të mbështetur nga Uashingtoni. "Trump kërkon pasuritë e Venezuelës, naftën, arin, gazin, hekurin, diamantet dhe pasuritë e tjera materiale", - shtoi ai.

Nicolas Maduro, presidenti i Venezuelës është shprehur se nuk do ta tradhtojë vendin e tij duke i plotësuar dëshirën Uashingtonit për ndryshimin e regjimit në vend. Ai tha se nuk do lejojë që historia ta kujtojë si tradhtar. "Nuk më intereson se si do të hyj në histori, por nuk do të jem një tradhtar, një njeri i dobët, një njeri që u kthen shpinën angazhimeve të tij historike ndaj popullit", - u shpreh Maduro në një intervistë ekskluzive me "RT Spanish". "Unë përfi-

Paris - A kishin realisht ndërmend t'i vinin flakën Francës, vetëm për disa cent më shumë? Më shumta se 8 javë pas fillimit, revoluta e "Jelekëve të verdhë", duket ende e vështirë të kuptohet. Për ekstremistët e të gjitha kampeve, të cilët shkaktoan zjarret, dukej si fillimi i shumëllojshëm i priturit e revolucionit të madh, por kjo gjë nuk u materializua. Të tjerët donin ta shihnin atë si rebelimin e të mjerëve të botës, përveç faktit që ata që po ngriheshin, nuk ishin më të varfrit. Por të gjithëve u mungon një pjesë thelbësore e enigmës: frika e madhe e të pasurit gjithnjë e më pak. Është një frikë që mund të gjurmohet në të gjitha vendet e zhvilluara dhe që padyshim shpjegon, në pjesën më të madhe, rritjen e tij që quhet shpesh populizëm. Dhe në Francë, kjo frikë është akute, edhe më e madhe se kudo tjetër. Ju duhet të ktheni pas në kohë, për të kuptuar se çfarë është në rrezik. Shekulli XX, ishte shekulli i "gjihtnjë e më shumë". Standardi i jetesës u rrit më shpejt në atë shekull se kurrë më parë në histori. Klasa e mesme u shfaq në Amerikë dhe në Evropë, duke u bërë grupim dominues në shoqëri. Burrat dhe gratë në këtë grup ishin të bindur se nesër do të ishte më mirë se sot, se fëmijët e tyre do ta kishin më mirë se ata. Dhe ky ishte realiteti përgjigjës gjysmës së dytë të shekullit. Por, dy ndryshime të mëdha e prishën situatën. Së pari, shtrimit i fitimeve të produktivitetit që nxiti të ardhura më të larta. Së dyti, ardhja e teknologjive të informacionit që favorizon vendet e punës me kualifikim të lartë (ata që dinë të shfrytëzojnë mundësitë e teknologjisë digjitale) dhe punët me aftësi kualifikimi të ulëta, mbi ato të mesme. Ky është polarizimi i punës, i përforcuar nga konkurrenca më e fortë ndërkombëtare. Në të gjitha vendet e zhvilluara, vendet e punës me të ardhura të mesme po zhduken në favor të vendeve të punës me të ardhura të ulëta, ose me të ardhura të larta. Pikërisht këtu nis të shfaqet frika. Klasat e mesme kanë tashmë frikë nga e ardhmja. Sidomos gratë dhe burrat më pak të trajnuar, të cilët kishin arritur njëfarë niveli rehatie. Ata kanë frikë për gjendjen e tyre, madje edhe më shumë për fëmijët e tyre. Perspektivat e tyre, horizonti i tyre po zhduket.

Rebelimi i të mjerëve të botës, apo frika nga populizmi në Francë?

Prapa "jelekëve verdhë", frika e të pasurit gjithnjë e më pak

Protesta ndaj rritjes së naftës, prapaskenat e tubimit



Askush nuk dëshiron të humbasë. Në Shtetet e Bashkuara rasti tipik është ai i punëtorit industrial që e humbet punën e tij. Ai gjen një punë të re në sektorin e shërbimeve, por është më i pasigurt, më pak i paguar dhe mbi të gjitha, me një mbrojtje sociale më të dobët. Ai është i inatosur dhe ka votuar Trumpin. Situata në Francë është e ndryshme. Punët mbrohen më mirë nga ligjet (por kjo nuk e ka penguar industrinë të kryejë shkurtime masive). Niveli i pagave ruhet dhe evoluon në varësi të marrëveshjeve kolektive. Një punonjës që gjen një punë të re pasi është përgjashuar nga skema e mbrojtjes aktuale sociale, edhe nëse mund të ketë boshllëqe në mbulimin social. Problemi nuk qëndron në sektorin privat. Kompanitë ishin në të vërtetë të kursyera kryesisht nga lëvizja e protestës së "Jelekëve të verdhë", e cila i ka vënë rrallë në shenjë ato. Pra, prej nga buronjë ankesat për "gjihtnjë e më pak"? Kryesisht nga sektori publik. Në fillim të vitit 2019, shembulli më i mirë është pa dyshim ai i pensioneve. Zyrtarisht, ekspertët thonë në zhargonin e tyre se "trajektorja është e qëndrueshme", pas

shumë reformave të kryera ndërmjet viteve 1993 dhe 2010. Përveç nëse kontributet do të rriten sërish dhe pensionet do të ulen sërish! Kjo do të thotë më pak para për punëtorët, të cilët paguajnë në sistemin e pensioneve dhe më pak fuqi blerëse për pensionistët, pasi pensionet e tyre do të rriten me një normë më të ulët se sa çmimet në përgjithësi, për të mos përmendur faktin se ata tashmë kishin për të paguar tatime shtesë vitin e kaluar. "Gjihtnjë e më pak", shkon përtej kësaj. Dhjetëra miliona francezë janë të prekur. Një ekip hulumtuesish nga Observatori Ekonomik Francez (OFCE), ka treguar se masat sociale dhe fiskale të miratuara midis viteve 2008-2016 kanë shkurtuar të ardhurat e disponueshme për familjet me 14 miliardë euro, ose 1.4 për qind. Kjo është padyshim e dhimbshme. Askujt nuk i pëlqen të humbasë. Ekonomistët e sjelljeve, e kanë shqyrtuar këtë neveri universale ndaj humbjes (madje është vërejtur edhe tek kafshët). Në thelb, efekti i një humbjeje është dy herë më i madh se efekti i një fitimi. Me fjalë të tjera, fatkeqësia e humbjes së një

JAPONI, NIS ASGJËSIMI I DERRAVE PËR SHKAK TË GRIPIT

FOTOLAJM

Autoritetet japoneze kanë intensifikuar luftën ndaj gripit të dërrit, pasi virusi u zbulua në shumë vende të Japonisë Qendrore. Ushtarët japonezë dhe zyrtarët e qeverisë lokale kanë nisur asgjësimin e rreth 6 600 derrave në një fermë të "Toyota City" në prefekturën e Aichi, pas konfirmimit të shpërthimit të epidemisë së derrave, e njohur edhe si kolera e dërrit.

SHKURT

Alarm për bombë në Rusi, evakuohen rreth 20,000 njerëz

Rreth 100 ndërtesa rreth kryeqytetit rus janë evakuuar për shkak të kërcënimeve me bombë. Një seri alarmesh të rreme të martën detyruan mijëra njerëz të dilnin nga banesat e tyre në Moskë. Fëmijët në shkolla, punonjësit e zyrës dhe klientët ishin ndër ata që kishin vetëm pak kohë që të dilnin e të boshatisnin 100 ndërtesa rreth qytetit. Në total, rreth 20,000 njerëz janë evakuuar nga ndërtesat publike, qendrat tregtare dhe shkollat në Moskë dhe në rrethina. Disa institucione, të tilla si Universiteti Shtetëror Rus i Shkençave Humane anuluan aktivitetet për gjithë ditën për shkak të ndërprerjes të shkaktuar nga evakuimi masiv. Kërcënime të ngjashme janë raportuar dhe në disa qytete të tjera si Krasnoyarsk në Siberi dhe Volgograd në jug.

Papa e pranon: Klerikët abuzuan seksualisht me murgeshat

Papa Françesku pranoi se klerikët i kanë abuzuar seksualisht murgeshat dhe se në një rast, ato janë mbajtur si sklave seksi. Ai tha se në atë rast, paraardhësi i tij, Papa Benedikti, është detyruar të mbyllë një kongregacion të tërë të murgeshave që janë abuzuar nga priftërinjtë. Kjo behohet se është hera e parë që Papa Françesku ka pranuar abuzimin seksual të murgeshave nga kleri. Ai tha se Kisha Katolike ka bërë përpjekje të adresojë problemin, por shtoi se ai "po vazhdon ende". Duke folur për gazetaret gjatë një turneu historik në Lindjen e Mesme, Papa tha se Kisha ka një problem, rrënjët e të cilit qëndrojnë në vlerësimin i grave "si klasë e dytë".

I shpërthen cigarja elektronike, vdes 24-vjeçari në Teksas

William Brown, 24 vjeç nga Teksas ka ndëruar jetë, dy ditë pasi u shtrua në spitalin e "Forth Worth", i plagosur rëndë me një cigare elektronike. Aparatura i shpërtheu ndërkohë që djali e kishte në përdorim duke i shkakuar edhe dëme në fytyrë. Sipas asaj që raporton "CNN", i riu u gjet në një parking përballë një dyqani me cigare elektronike. Pronari i dyqanit tregoi se 24-vjeçari kishte kërkuar ndihmë për të përdorur pajisjen, të cilën e kishte blerë në një vend tjetër. Sapo mbërriti në spital, kushtet e djalit ishin kritike dhe një pjesë e pajisjes i kishte mbetur në fytyrë. Pasi kaloi në koma, William humbi jetën si pasojë e një infarkti cerebral.



bëhen dhe gabime, por jo kaq të trasha?! Unë e di fort mirë, dhe nuk i shpëtoj dot përgjegjësisë së korruptimit flagrant që ndodhi me dhënie para qesim të doktoraturave, ku o burra, kush e kush të ngarkonte sa më shumë të tilla në shpinë, si hamejtë thasët e çimentos, për të fituar ca më shumë para nga sa u jep shteti rrogë. Kjo specia e doktorantëve, si zombit që dalin me qindra, i shqyen dyert, dhe na u bë deti kos! Universitetet private i degradoan fare, nga 300 copë. O Zot! Të bëheshe "Doktor i Shkencave" motit duhej b... Po ku është krenaria e dikurshme e një Egrem Çabej, Aleks Bude, Shaban Demiraj apo Kristo Frashëri? Janë dimensione të mëdha. Nuk bëhet kollaj figura e një studiuesi me dimensione të tilla, duhen male librash, vullnet fort i madh, ulur në tryezën e punës gjër në harrim të vetes, të gruas, të ushqimit... Dhe modele të tilla janë duke u shuar. Po pse? Unë fajin kryesor ia hedh pavëmendjes së shtetit, verbërisë së tij. E si mund të bëhet një studiues i tillë, kur pozita e tij sociale ka rënë përtokë?! Një profesor sot nuk shkon dot në një sesion, simpozium a konferencë shkencore jashtë Shqipërisë, për shembull në Gjermani, në Francë, në Belgjikë, në Amerikë a gjër në Australi, po të doni ju, pa parë në xhep që të paguajë hotelin, ushqimin dhe dy kafe në ditë? A i del rroga vallë? Qysh këtu merret vesh përgjigja: të gjithë i refuzojnë ftesat e shumta që vijnë nga institucionet homologe për të kumtuar nëpër forume të tilla shkencore ndërkombëtare. Rezultati? Kurrë nuk konfirmohet apo argumentohet aty për vlerat tona si komb, ku edhe duhet folur më fort përballë të tjerëve. Asiherë bëjmë gic-mic nëpër ca gazeta e televizione për të dëgjuar njëri-tjetrin në deliret didjedhëse dhe fjalomaninë pa vlerë. Doemos shteti e di gjenden, por mbyll një sy, ka bezd: "Oh, ç'më çani kokën dhe ju... mizat!...", thotë pabëzajt ai dhe shpëlan duart si Ponc Pilati, nuk jep asnjë kacidhe për ekspeditat shkencore, për hulumtime

nëpër arkiva jashtë ku fle historia e shqiptarëve, për pjesëmarrjen në veprimtari e forume shkencore në Evropë e më tej. Vallë kështu mund të bëhet Akademia e Studimeve Albanologjike qendra e albanologjisë në botë?! Brofka! Dhe "struku, struku, i shkretëti plak!", siç thotë fjala, në këtë ftohme të përgjithshme që i është vërvitur këtij institucioni unikël e tejet të rëndësishëm të kombit, ftohme që s'po ikën akoma, ardhur nga mendjengushtësia e qeverive shqiptare, majtas apo djathtas, bjerrakohës pa vlerë. Shikoni pak, vetëm dy-tri shifra, që gjithçka të bëhet tejet e rrokshme: Në Shqipëri ndahet vetëm 0.1% e buxhetit për kërkimin shkencor, në Kosovë e Maqedoni 0.5% (pra pesë herë më shumë), në Bullgari 1.2%, pra 12 herë më shumë se ne. Po e përsëris: dymbëdhjetë herë. Vallë ka veshë qeveria ta dëgjojë? Sigurisht që ka, por bën shurdhmedin. Duhet një shkundje që t'i shkojë një fill zëri në kërmill të veshit. Demonstratat e studentëve e bënë atë që ta dëgjojë, më në fund, lëngatën e universiteteve, gjenden ulëritëse të tyre. Dhe ka filluar të rikuperojë të çarat e mëdha, t'i qepë copacopa ku të mundet, pa u hapur krejt thesi përfundi. Mirë universitetet se kanë zemërimin e studentëve, por Akademia e Studimeve Albanologjike çfarë ka?! Çelësat e kashës ka. Ankesat e dhimbjeve të saj s'kanë nevojë për mbushje sheshesh me studentë apo mitingje gjithëfarlojesh. 36 profesorët e saj, tok me 12 asistentë profesorët, një aset punëdashës, i heshtur, i përkorë, mbi libra e tryeza studimesh, nuk janë modeli i llapa-llapëve nëpër emisione gati të shpifura, që kapitin dhe shpëlajnë trutë e njerëzve. Këta janë njerëz të ndëruar, zotërinj qeveritarë të sotëm, apo ju që mëtoni të bëheni në nesërmen, me "kryengritje" apo me zgjedhje elektorale, puna juaj! Jepuni kushtet e dobishme profesorëve të tillë si Pëllumb Xhufi e Marenglen Verli, Beqir Meta e Valter Memishaj, Luan Përzihita e Anila Omari, Hamit Kaba e Stefan Çapaliku, si dhe të ngjashmëve të tyre. Studiuesit e shquar po pensionohen, por ç'mbetet pas? Edhe kjo është një plagë e hapur, një merak. Studiuesit me emër ikin nga institutet e akademisë, shkojnë në universitete ku paga është më e lartë. Fare thjesht: dyfishoni pagat, ju që nuk shihni përtej hundës suaj dhe syrit opak, që ju mungon vizioni evropian. Edhe më shumë madje, ju lipset të krijoni kushtet për hulumtim e studim, jepuni shansin e merituar profesorëve, këtyre heshtanëve fisnikë, që të kumtojnë nëpër katedrat universitare të botës, të bëhen pjesë e veprimtarive shkencore ndërkombëtare, të flasin për Shqipërinë, për vlerat e këtij kombi, të çojnë e të sjellin me vete krenarinë e munguar. Por kjo bëhet me vepra, dmth me para, jo me fjalë e premtime boshe, boll me to se u stërlodhëm. Ka ardhur koha që shteti shqiptar të bëhet një Mecenë, Mecena i madh, sepse është shprehësi i interesit dhe vetëdijës kombëtare absolute. Bëje shtet tani, se dikush tjetër nesër doemos do ta bëjë! Bëje!...

KOMPOZITORI

Thoma Gaqi në 70-vjetorin e lindjes



Universiteti i Arteve i akordoi titullin "Profesor Emeritus", kompozitorit dhe profesorit Thoma Gaqi në 70-vjetorin e lindjes. Kjo është hera e parë që Universiteti i Arteve nderon me një çmim honorifik një ndër personalitetet e shquara të artit shqiptar.

Përgjatë një mbrëmjeje të veçantë muzikore e ceremoniale, dekani i Fakultetit të Muzikës, z. Isak Shehu dhe rektori i Universitetit të Arteve, z. Kastriot Çausi, në emër të njësisë bazë dhe senatit akademik akorduan titullin "Profesor Emeritus", kompozitorit Thoma Gaqi. Titull ky që u atribuohet personalitetëve të larta për meritat të jashtëzakonshme profesionale. Koncerti portret u organizua nga Fakulteti i Muzikës. Interpreti orkestra simfonike e Universitetit të Arteve nën drejtimin e Alqi Lepurit. Solist Lorenc Radovani. Mbrëmja muzikore u çel nën tingujt e poemës simfonike "Borova". Kjo vepër, jo rastësisht përzgjedhur për të çelur këtë mbrëmje muzikore ceremoniale është edhe vepra e diplomës e kompozitorit, Thoma Gaqi. Shkruar më 1972, poemi simfonik "Borova" frymëzohet nga masakra e Borovës, tragjedia e fshatit juglindor të Shqipërisë. Në vazhdim, mbrëmja muzikore vijoi me Poemin koncert për violinë dhe orkestër, Vallen nr. 2 nën drejtimin e dirigjentit Agron Kapllani dhe Skerco. Të gjitha këto, pjesë të njohura të krijimtarisë muzikore të Thoma Gaqi.

JETA E THOMA GAQIT

Thoma Gaqi lindi në qytetin e Korçës më 1948. Mësimet e para muzikore i mori në qytetin e lindjes. Pas përfundimit të shkollës fillore, vazhdoi studimet për violinë dhe teori muzikë në Tiranë, në Liceun Artistik "Jordan Misja". Më 1966 nis studimet e larta për kompozicion në klasën e prof. Çesk Zadesë, i cili pati një ndikim të rëndësishëm në



Profesorit Thoma Gaqi gjatë ceremonisë së 70-vjetorit të lindjes ku u nderua me titullin "Profesor Emeritus"

formimin e kompozitorit të ri. Përgjatë studimeve të tij, Gaqi spikat për talentin dhe originalitetin krijues. Në jetën e Thoma Gaqit nuk mund të mos përmendet edhe martesat me muzikologjen Irsha Skëndi Gaqi (1973), e cila së bashku me dy djemtë e tyre, pianistët Pirron dhe Gjergjin u bënë bashkudhëtarë në jetën krijuese të kompozitorit.

KRIJIMTARIA MUZIKORE

Krijimtaria muzikore e Thoma Gaqit është e shumanshme. Ai ka kompozuar vepra instrumentale (Suite për piano, Varicione për piano mbi dy tema, koncert për violinë dhe orkestër, poemë koncert për violinë dhe orkestër, rapsodi koncert për violinë, violonçel dhe orkestër, koncert për violonçel dhe orkestër, sekro për dy violina), orkestrale (Borova, Rapsodia nr. 1-2, Valle simfonike nr. 1-2-3, Koncert për orkestër harqesh, etj.), vokalo-simfonike (Poemë vokale, Poemë vokalo-simfonike etj.), si edhe muzikë filmi (tek filmat "Përballimi" dhe "Maratonaku").

Individualiteti i tij krijues dalon si nga përdorimi i formave muzikore, ashtu edhe nga pikëpamja harmonike. Stili kompozicional i Gaqit karakterizohet nga thellësia e përmbajtjes, emocionaliteti, simfonizmi si edhe kontrastet tematike. Gjithashtu, karakteristikë në veprat e tij është përdorimi i harmonisë modale dhe politonale. Mjeshtëria kompozicionale e Gaqit qëndron pikërisht në aftësinë për të artikulluar një gjuhë muzikore bashkëkohore bren-

da formave klasike, ku marrëdhëniet e konsonancës me dizonancën parashtrihen me mjeshtëri të veçantë. Një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e Gaqit, zë edhe muzika tradicionale shqiptare. Sikurse e ka përkufizuar edhe muzikologu Albert Papparisto, në krijimtarinë e Gaqit, muzika popullore herë rikrijohet e herë citohet.

Përveç krijimtarisë artistike, Thoma Gaqi ka një kontribut të veçantë në fushën e pedagogjisë. Prej shumë vitesh ai ka qenë titullar i lëndës së Harmonisë, duke qenë një pikë e fortë referimi për të gjithë studentët e Fakultetit të Muzikës. Gjithashtu, ka një kontribut të veçantë në formimin e kompozitorëve të brezave në vazhdim. Nga klasa e Thoma Gaqit mund të përmendim disa nga kompozitorët bashkëkohorë në zë si Endri Sina apo dhe me të rinjtë Fatos Lumani, Gerti Drua si edhe shumë të tjerë. Ndraga klasës së Thoma Gaqit kanë studiuar edhe disa prej pedagogëve të sotëm të Fakultetit të Muzikës si Lorenc Treska, Arian Brahimi etj.

Përgjatë jetës së tij profesionale, Thoma Gaqi ka mbajtur një sërë postesh të rëndësishme drejtuese si Udhëheqës artistik në Teatrin e Operës dhe Baletit, drejtor i shkollës së mesme artistik "Tefta Tashko" në Korçë si edhe ka kontribuar si drejtor artistik në disa edicione të Festivalit Folklorik të Gjirokastrës.

Opinion i Ditës

A është Ballkani në rrezik të ndonjë konflikti ushtarak?

Nga Mujë Buçpapaj

(vijon nga faqja 1)

... Siç komenton "Evropa e lirë", "mundësia e një konflikti të hapur ushtarak dhe ndikimi i Rusisë mbeten kërcënimet kryesore për sigurinë e Ballkanit Perëndimor për vitin 2019, e cila i referohet raportit të Komunitetit të Inteligjencës së SHBA-ve rreth vlerësimit të kërcënimeve në botë për vitin 2019".

Ndërsa nuk dihet si do të jetë përfundimi i bisedimeve Kosovë-Serbi, një gjë është e qartë se qeveria e Prishtinës është e vendosur të refuzojë çdo presion, që kompromisi të ndërtohet mbi lëshimin e territoreve në veri të lumit Ibër dhe rrudhjen e mëtejshme të Kosovës.

Nëse institucionet e sigurisë në Kosovë kanë shmangur deri tani konfliktin me strukturat paralele serbe në veri të Mitrovicës, është e qartë se kryeministri Haradinaj nuk do të tolerojë më tej mbajtjen e këtij territori jashtë kontrollit të plotë të qeverisë së Prishtinës.

Nga ana tjetër, Beogradi nëpërmjet strukturave të veta do të përpiqet të minojë çdo përpjekje diplomatike të Kosovës për të arritur një paqe me nder me Serbinë, duke ruajtur integritetin e shtetit të vet.

Protestat e serbëve në veri të Mitrovicës me sillogane që kundërshtojnë projektin për bashkimin e qytetit është një paralajmërim se burimi i konfliktit është ende i fortë dhe i frymëzuar jo vetëm nga mitet që e patën filluar luftën në Kosovë 20 vjet më parë, por edhe nga strukturat shtetërore serbe të mbështetura edhe nga Rusia.

Vizita e fundit e presidentit rus në Serbi, bilës edhe në bazën ushtarake të Nishit, ngjitur me Kosovën, ishte një inkurajim për serbët, sido që me tone më të zbutura prej tij.

Rusia nuk do mend që vijon t'i japë garanci Serbisë për të rritur presionet ndaj mbështetësve perëndimorë të Kosovës, përfshirë edhe SHBA-ve, për t'u imponuar shqiptarëve "lëshimin e madh" përpara njohjes së shtetësisë nga pala serbe.

Vetë paralajmërimet e administratës amerikane ndaj qeverisë së Prishtinës për të shfuqizuar takimin 100% ndaj mallrave me origjinë serbe është një rezultat jo tërësor i revoltës apo protestës serbe, por edhe i kërcënimeve diplomatike ruse se Beogradi mund të braktisë dialogun, gjë e cila mund të rikthente bisedimet në fazën fillestare, për çfarë aleatët tanë perëndimorë nuk janë të interesuar.

Inteligjencia amerikane nuk ndodhë që të gabojë në parash-



ikimet e saj dhe mundësia e një konflikti mund të ketë si vatrë përsëri Kosovën dhe hapësirat shqiptare si Maqedonia e Veriut, ku dasitë etnike janë të forta, pavarësisht përparimeve të dukshme të kohëve të fundit, mbetet një vend me stabilitet të brishtë, korrupsion të lartë dhe varfëri, sidomos në rajonet e shqiptarëve etnikë.

Partia konservatore në opozitë ka paralajmëruar se me t'u kthyer në fuqi, do të shfuqizonte "Marëveshjen e Prespës" për emrin dhe bashkë me të, edhe ligjin që u lejoi shqiptarëve përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe, përfshirë edhe në parlament, krahas asaj sllavo-maqedonase.

Ndërsa nuk ka akoma një dokument bazë që do të çonte në përmbylljen e bisedimeve, apo edhe në refuzimin e tyre, negociatorët shqiptarë përfshirë, edhe presidentin Thaçi janë shfaqur konspirativë duke mos dhënë detaje rreth kushteve të marëveshjes dhe as parashikimit të saj.

Nëse marrëveshja përfshin shkëmbime territoresh apo popullsisë, kjo nuk është e qartë, pasi edhe vetë deklaratimet e zoti Thaçi, përfshirë edhe intervistën e fundit në Tiranë, janë kontradiktore dhe në ndryshim të vazhdueshme.

Ndërsa debatet, me shumë me frymë partizane se sa nacionale, kanë vijuar dhe do të vijojnë, ajo që ka lënë shije të keqe është se

ndërsa Ballkani dhe hapësira shqiptare mund të përfshihet në një konflikt të ri, politika shqiptare në Tiranë dhe Prishtinë duket e ndarë dhe e përçarë si kurrë më parë. Akoma më keq e përfshirë në një debat ku dominon fjalori i ashpër dhe ofendimet e ndërsjella, në vend të uljes në tavolinë për të dëgjuar njëri-tjetrin dhe formuluar një qëndrim të qartë, mundësisht me konsensusin më të gjërë.

Megjithatë, letra e Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, drejtuar Presidentit të Kosovës Hashim Thaçi dhe Presidentit të Serbisë Vuçiq dëshmon se në Uashington interesimi për suksesin e bisedimeve është bërë i fortë, po aq edhe arritja e një marrëveshjeje paqeje. Padyshim, përfshirja amerikane në këto bisedime ka qenë një kërkesë e opinionit shqiptar dhe është garanci e fortë se interesat shqiptare do të mbrohen si gjithmonë prej aleatëve tanë strategjikë dhe të përherëshëm, SHBA-ve, dëshmi për këtë është edhe qëndrimi i fortë amerikan për krijimin e ushtrisë së Kosovës.

Çështja është se sa janë vetë shqiptarët të gatshëm për të bërë kompromise me njëri-tjetrin, ndërsa protestat në Shqipëri mund të marrin drejtim të paparashikuar. Korrupsioni i përhapur, reformat e stopuara apo të stërvonura dhe varfëria e paparë ndonjëherë gjatë 30 vjetëve të fundit mund të çojnë

vendin në spirale dhune dhe konfliktesh.

Një situatë e tillë mund të çonte në trazira të brendshme, të ngjashme me ato të 20 viteve më parë, që patën rrënuar institucionet shtetërore dhe vetë demokracinë shqiptare.

2.

Në rast të një konflikti ushtarak në Ballkanin Perëndimor, përveç shumë dobësive të reja, Shqipëria dhe shqiptarët kanë një epërsi të madhe në krahasim me vitet 1997-1999.

Shqipëria është anëtare e NATO-s, ndërsa Kosova një shtet i pavarur. Të dyja bashkë kanë ushtri të reja dhe të mirëtrajnuara nga aleatët perëndimorë.

Në Kosovë gjendet prej vitesh një bazë e fortë ushtarake e NATO-s, ndërsa në Shqipëri sapo ka nisur rindërtimi i bazës së vjetër ajrore të Kuçovës, nga më të njohurat e ish-blokut komunist.

Kjo infrastrukturë e sofistikuar teknike dhe sigurimi i aleancave të fuqishme i ka rritur kapacitetet mbrojtëse të shqiptarëve, por dobësia vjen nga zhvillimet e brendshme, qeverisja e dobët, korrupsioni dhe mosbesimi qytetar se vendi është duke ecur përpara.

3.

Demokracia ka pësuar regres për shkak të zgjedhjeve të diskutueshme dhe shpesh të manipulua-

ara, korrupsionit të kudogjendshëm brenda dhe jashtë qeverive, brenda dhe jashtë partive, më së shumti të një administratë partizane, e cila bazohet jo tek meritokracia, por tek partishmëria dhe blerja e vendeve të punës në të gjitha nivelet, fenomen ky i kthyer në një kancer të rëndë për shoqërinë tonë.

Këtë nivel të ulët demokracie për fat të keq e shohim edhe tek partitë politike, të cilat kanë hequr dorë prej vitesh nga demokracia e brendshme, nga gara e ndershme dhe konsultimi me mbështetësit e tyre tradicionalë.

Partitë politike, të dominuara kryesisht nga njerëz pa ndonjë interes të shprehur kombëtar, ndryshe flasin në opozitë dhe krenjtë ndryshe sillen ku janë në pushtet.

Listat e mbyllura në të gjitha nivelet e zgjedhjeve i kanë shkëputur lidhjet me anëtarësinë përkatese, duke i nxjerrë partitë jashtë interesit publik.

Kjo mënyrë drejtimi i ka sjellë deri tani përfitimë klaneve që drejtojnë partitë dhe rretheve të ngushta financiare që qëndrojnë pas tyre, por u ka kthyer shpërnjë mijëra militantëve dhe mbështetësve, të cilët kanë bojkotuar dhe do të bojkotojnë edhe më shumë këto parti.

Çlirimi i partive prej elitave të korruptuara dhe të kompromentuar është hapi i parë i kthimit të besimit qytetar në sistemin politik të vendit dhe vetë demokracinë.

Elitat, apo pseudo-elitat që ua kanë shndërruar në ferr jetën miliona shqiptarëve, të cilët kanë zgjedhur të jetojnë këtu dhe të mos largohen akoma nga vendi, siç kanë bërë miliona shqiptarë të tjerë në këto vite, thua se në vend të këtë rënë një epidemie e rëndë.

Në fakt, epidemia më e rëndë qenka mashtrimi me demokracinë, varfëria shfarosëse dhe poshtëruese për miliona shqiptarë, blerja me para e çfarëdolloj shërbimi publik, nëpërkëmbja e intelektualëve dhe sidomos inteligjencës krijuese, e cila rron për bukë e gojësi si dhe vrasja e shpresës të të rinjtë.

Si mund të ketë besim në një demokraci, kur më i korruptuari flet për luftën kundër korrupsionit, kur më tradhtarit flet për interes kombëtar, kur postblërit flet për garë të ndershme dhe postshitësi për virtyt demokratik, kur prostituta bën të ndershmen dhe më ndershmi bën prostituten politike për një karrige dhe tender.

Si mund të ketë besim në një demokraci, kur qeni dhe i biri qenit kanë privatizuar me letra false edhe tokën, edhe detin. →

DO LUHET SHQIPËRI-MOLDAVI



Problemi me rimbursimin e TVSH dhe gjyqi me Ministrinë e Financave ka kaluar në plan të dytë pasi Federata Shqiptare e Futbollit ka qenë e detyruar të përcaktojë emrat e stadiumeve ku do të zhvillohen ndeshjet e vlefshme për kualifikueset e Euro 2020. Në këto kushte, FSHF ka vendosur që

Zyrtare, "Arena Kombëtare" hap dyert më 11 qershor

ndeshje e parë, e cila do të zhvillohet në stadiumin e ri "Arena Kombëtare" të jetë ajo kundër Moldavisë në program për t'u zhvilluar më 11 qershor. Federatës Shqiptare të Futbollit i mungojnë 2 milionë euro në arka, shumë e cila vendosi

në pikëpyetje përfundimin e stadiumit, të paktën kështu u fol nga zyrtarët e FSHF-ës, por përballë faktit ku duhet të dorëzonin emrat e stadiumeve, drejtuesit e Federatës vendosën datën 11 qershor për inaugurimin e stadiumit.

VDEKJA E SALA



Nanta dhe Kardifi, "sherr" për 15 milionë stërlina

Emiliano Sala nuk arriti kurrë të zbriste në fushën e lojës me fanellën e Kardifit. Argentinasi, që humbi jetën pak ditë më parë teksa po udhëtonte nga Nanta drejt Uellsit, është kthyer në një mollë shërri mes klubeve. Nanta, e cila e shiti zyrtarisht Emiliano Sala të klubi i Premier Ligës, pretendon të paguhet sipas kontratës së bërë me Kardifin. Francezët e shitën kartonin e lojtarit të tyre për një shumë të konsiderueshme prej 15 milionë stërlinash. Kardifi, nga ana e tij, ka deklaruar se do ta respektojë marrëveshjen. Sipas akordit të nënshkruar, Kardifi do ta depozitojë shumën prej 15 milionë stërlinash me tre këste gjatë tre viteve të ardhshme. Por Nanta është bërë gati për rrugët ligjore, nëse kësti i parë i parave nuk derdhet në arkat e klubit brenda 10 ditëve.



Jeton Selimi

Të mëdhatë nuk vuajnë dhe fitojnë me lehtësi. Një gol i Bitrit kualifikon Kamzën në dëm të Vllaznisë

"Luftë" në Vlorë, Tirana eliminon Flamurtarin

Kuqezinjtë protestojnë për një penallti të padhënë

Asnjë rezultat surprizë nuk dhuruan ndeshjet e kthimit në turin e dytë në Kupën e Shqipërisë, me ekipet e Superligës, të cilat konfirmuan supermacinë e tyre. Tirana është kualifikuar mes polemikash në takimin e kthimit të vlefshëm për turin e 1/8-ve të Kupës Shqipërisë. Pavarësisht humbjes me rezultatin 1-0, bardheblutë i janë falur triumfit 2-0 në takimin e parë. Një penallti e mohuar në fundin e lojës ka irrituar futbollistët e Flamurtarit, të cilët e shikojnë veten jashtë Kupës së Shqipërisë. Tirana e mbylli pjesën e parë me 10 lojtarë, teksa Grent Halili u ndëshkua me karton të kuq, për goditje ndaj Elton Kale. Ndërkohë me fillimin e pjesës së dytë vlonjatët gjetën golin e avantazhit me brazilianin, i cili goditi saktë në hyrje të zonës. Pavarësisht përpjekjeve, Flamurtari nuk arriti të gjente golin e dytë, për ta çuar ndeshjen në shtesë.

Kukësi mposhti Apoloninë pastër 2-0 duke bërë "nul" fitoren e fierakëve në takimin e parë. Ekipi i Armando Cungut kalon më tej



KUPA E SHQIPERISE

GRUPI A

Partizani-Kastrioti 3-0 (4-2)
Skënderbeu-Besëlidhja 3-0 (2-1)
Luftëtari-Egnatia 0-0 (3-0)
Kamza-Vllaznia 1-0 (1-2)

GRUPI B

Kukësi-Apolonia 2-0 (1-2)
Laçi-Bylis 3-0 (0-2)
Teuta-Lushnja 4-0 (3-1)
Flamurtari-Tirana 1-0 (0-2)

ÇEREKFINALET

GRUPI A

Kamza - Skënderbeu
Partizani - Luftëtari

GRUPI A

Teuta-Kukësi
Tirana-Laçi

ku në çerekfinale ku përballë do të këtë Teutën, skuadër e cila sigurojë kualifikimin pasi mposhti Lushnjën me rezultatin e përgjithshëm 7-1.

Kupa duket se është i vetmi vend ku Skënderbeu mund të marrë rezultat pozitiv, pasi fitorja e fundit daton pikërisht kundër Besëlidhjes. Korçarët mposhtën lezhjanët edhe në sfidën e kthimit me rezultatin 3-0 duke siguruar një biletë për në çerekfinale aty ku do të përballen me Kamzën. Ekipit të Ernest Gjokës i mjaftoi një gol i Bitrit për të likuiduar Vllazninë.

Partizani vijon marshimin edhe në Kupë teksa mposhti Kastriotin me rezultatin e pastër 3-0, në çerekfinale do të përballen me Luftëtarin.

Marrëveshja deri në vitin 2024

Akord mes UEFA-s dhe klubeve kundër dhunës dhe trukimeve



gociatave, të mos hasë në kundërshtinë e ECA sa u përket sanksioneve që ajo jep për shfaqjet e dhunës apo

për trukimet e ndeshjeve. "Marrëveshja e rinovuar përforcon përkushtimin e UEFA dhe ECA për të mbrojtur in-

tegritetin e lojës dhe ta mbrojë atë nga rreziku që vjen nga dhuna, trukimet dhe dopingu. Projekti afatgjatë për këtë lojë tregohet nga dëshira e përbashkët për të zhvilluar dhe përmirësuar më tej Fair Play Financiar, por gjithashtu, të përmirësojë kalendarin ndërkombëtar të ndeshjeve pas vitit 2024", shkruhej në njoftimin e përbashkët të publikuar nga palët pas firmës. Në ECA aderojnë edhe klube shqiptare, me Kukësin që është një anëtar i zakonshëm i kësaj shoqate, si dhe Vllazninë, e cila regjistrohet si një tjetër klub që i është bashkuar asaj. Më parë, pjesë e kësaj organizate kanë qenë edhe Tirana, Dinamo e Elbasani.

Napoli prish marrëveshjen

Dështon kalimi i Marek Hamshik në Kinë

Marek Hamshik i kishte mbyllur të gjitha me Dalian Yiafang. Napoli do të arkëtonte 18 milionë euro nga transferimi i kapitenit të tij në Kinë, lojtari një kontratë fantastike prej 10 milionë eurosh në sezon për tre vitet e ardhshme. Por gjithçka ka dështuar kur pritej vetëm udhëtimi i fundit i Marek Hamshikut në Kinë, me skuadrën që i bëri dhe një ceremoni lamtumire kapitenit të saj. Sipas asaj që flitet, ka qenë Napoli që ka hedhur dëgjën në erë, pasi sipas klubit italian nuk ka pëlqyer ndryshimin e modulit të pagesës së shifrës prej 18 milionë eurosh.



